

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7837 E diel 31 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Shqipëria është si gjithmonë një martesë e palumtur e trashëgimisë së shkuar, që nuk ka ikrur ende dhe tentativës për modernizim, që nuk ka mbërritur akoma ...

Vijon në faqen 21

Nga LORENC VANGJELI

Politika e çimkave me çimka



Analiza *e* **Ditës**

Masakra e Tivarit vjen sot e plotë me dokumente arkivore nga arkivat shqiptare, jugosllave, britanike, amerikane, si edhe me dëshmi autentike të ...

Vijon në faqen 22

Nga URAN BUTKA

Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar



Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje

ATP: Kompensimi i pronave, ditën e hënë nis aplikimi, publikohet formulari

Procedura për të kërkuar paratë e pronës së humbur. Kostoja e dorëzimit të kërkesës, 2 mijë lekë

Të gjithë pronarëve që u është toka nga ndërtimet pa leje dhe kanë një vendim për kompensim nga Këshilli i Ministrave, për të marrë kompensimin duhet të plotësojnë formularin tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 01.04.2019 dhe nuk do të jetë i ...

Në faqen 7

ATENTATI NE SHKODER/ DYSHOHET PER HAKMARRJE. KUSH ISHIN VELLEZERIT BILALI

EKZEKUTOHEN BABAI DHE XHAXHAI I ISH-BOKSIERIT

Vriten në hyrje të shtëpisë Astrit dhe Brahim Bilali. Autorët djegin pjesërisht makinën e krimit. Ish-sportisti Asmer Bilali u arrestua si pjesë e grupit "Bajri"



(Në foto) Policia në vendin e vrasjes. Viktimat Astrit dhe Brahim Bilali

Në faqet 2-3

KRYEMINISTRI

Rama: Politika dhe media e llumit kanë shtrembëruar raportin e DASH-it

Në faqen 6

"SHQIPTARET PO VIDHEN"

Basha në Durrës: Edi Rama, fatura 100 mijë euro në orë për "estrada"

Në faqen 5

HASHASH E KOKAINE

Operacionet antidrogë, 7 veta në pranga në Tiranë e Memaliaj

Në faqen 11

VEPRA E POETIT

Dorëshkrimet e Santorit, si u fshi firma e Fishtës pas sekuestrim

Në faqen 12

"MILOSAO"



Për herë të parë: Sami Frashëri në kujtimet e gazetave të kohës në Stamboll

Suplement

Emrat/ Trashëgimtarët e të dënuarve, 3 muaj kohë për plotësimin e dosjes

1 mijë të përndjekurit që marrin paratë

Lista e plotë/ Dokumentet duhet të dorëzohen në Ministrinë e Financave

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 1 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit



të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar ...

Në faqet 8-10

ATENTATI NE SHKODER HETIMET

ASMER BILALI

29-vjeçari, i cili u arrestua në shtator të vitit që shkoi si pjesë e grupit kriminal "Bajri" është ish-kampioni boksit dhe një emër i njohur i sportit në Shkodër. Në vitin 2012, Asmeri u kualifikua për në Lojërat Olimpike "Londër 2012". 29-vjeçari është person me precedentë të mëparshëm, pasi cilësohej si i dyshuari kryesor për plagosjen e 20-vjeçarit Hermes Beqiri në një nga lokalet e Shkodrës. Ngjarje kjo e ndodhur në vitin 2017.



SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar përmes një postimi në "Facebook", lidhur me vrasjen e dy vëllezërve Astrit dhe Brahim Bilali në Shkodër. Ndërsa e konsideron Shkodrën nën darën e krimit, Berisha shkruan se dënon me ashpërsinë më të madhe qëndrimin e papërgjegjshëm dhe kriminal të narkoqeverisë dhe narkopolicisë, që e kanë vendosur Shkodrën nën sundimin e bandave të lidhura me pushtetin.



FLAMUR NOKA

Ish-deputeti Flamur Noka, përmes një statusi në "Facebook" ka reaguar pas atentatit në Shkodër. Noka tha se Lleshaj nuk po bën asgjë në drejtimin e Ministrisë së Brendshme, ndërsa shtroi pyetjen se "çfarë do bëhet me 4 bandat kriminale që citoi ambasadori i SHBA-ve". Noka u bëri thirrje shqiptarëve që të bëhen bashkë për të larguar Ramën, si e vetmja mënyrë për të mbrojtur veten dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Historia e viktimit, njëri biznesmen hipizmi e tjetri drejtues i shoqatës "2 Prilli"

Atentati mafioz, një nga vëllezërit e vrasë, babai i anëtarit të grupit "Bajri"

Ish-kampioni i boksit, Asmer Bilali, u arrestua në shtator të 2018-ës

SHKODËR

Njëri nga vëllezërit e ekzekutuar në atentatin e djeshëm në Shkodër është Astrit Bilali, babai i Asmer Bilalit, i arrestuar si pjesë e grupit "Bajri" në shtator të vitit 2018. Ish-kampioni i boksit i ekipit "Vllaznia" u vu në qendër të vëmendjes së mediave disa muaj më parë, ku mbeti i vrasë në një atentat shoku i tij, Arjan Ferracaku, teksa kalëronte në resortin e të atit, Astrit Bilalit. Në atë kohë u dyshua se ishte i riu Bilali, shënjestra e autorëve të krimit. Ai është ish-kampion boksit dhe një emër i njohur i sportit në Shkodër. Ndërkohë që në vitin 2012, Asmeri u kualifikua për në Lojërat Olimpike "Londër 2012". 29-vjeçari është person me precedentë të mëparshëm, pasi cilësohej si i dyshuari për plagosjen e 20-vjeçarit Hermes Beqiri në një nga lokalet e Shkodrës. Ngjarje kjo e ndodhur në qershor të 2016-ës, ku u dyshua se Asmer Bilali u ka siguruar autorëve armët pa leje. Në atë kohë u arrestua edhe babai i tij, Astrit Bilali, i cili u vra dhe në atentat së bashku me të vëllanë, Brahimin. 59-vjeçari u kap në atë kohë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij u gjetën armatime, të cilat i dispononte pa lejen e autoriteteve. U sekuestruan: 1 çifte, 1 pistoletë me mulli pa numër, 1 armë gjahu "Shotgan", 1 thikë dhe 25 fishekë, që i posedonte pa



Ish-kampioni i boksit, Asmer Bilali



Astrit Bilali

leje. Po ashtu, u arrestua edhe Brahim Bilali, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij u gjetën 3 kallashnikovë, 1 silenciator, 1 armë zjarri automatike e shkurtër me krehër, me silenciator pa numër, 2 krehra pistoletë tip "TT", 3 krehra me fishekë automatiku, 7 kallëpe tritolit 200 gr, 1 kuti

me kallëpe tritolit, 10 kapsolla detonatore elektrike me përcjellës, 12 kapsolla detonatore pa përcjellës, 23 fishekë armë gjahu dhe 190 fishekë model 56. Viktima e atentatit të djeshëm, Astrit Bilali ishte një biznesmen i njohur në qytetin e Shkodrës. Ai kishte në pronësi të tij një resort hipizmi në

VËLLEZËRIT BILALI

Astrit Bilali ishte biznesmen i njohur në qytetin verior dhe kishte në pronësi një kompleks hipizmi në zonën e Kirasit. Ndërsa, i vëllai, Brahim është i njohur në Shkodër, sepse ka qenë një pjesëtar aktiv në lëvizjen e 2 prillit në fillim të viteve '90-të në Shkodër. Ai ishte drejtues i shoqatës "2 Prilli". Brahim Bilali ka qenë kampion i hipizmit vite më parë dhe ka marrë pjesë në kampionate të ndryshme.

zonën e Kirasit, pasion të cilin ia ka trashëguar edhe djalit të tij, Asmerit. Viktima tjetër, Brahim Bilali është i njohur në Shkodër sepse ka qenë një pjesëtar aktiv në lëvizjen e 2 prillit në fillim të viteve '90 në Shkodër. Ai ishte drejtues i shoqatës "2 Prilli". Brahim Bilali ka qenë kampion i hipizmit vite më parë dhe ka marrë pjesë në kampionate të ndryshme. Më 1 prill të vitit 2015, presidenti i asaj kohe, Bujar Nishani i kishte dhënë dekoratë Brahim Bilalit. "Dekorata e Artë të Shqiponjës" ju akordua me numër dekreti 9030, me motivacionin: "Në vlerësim të veprimtarisë të spikatur kundër diktaturës dhe shtypjes, si dhe sakrificave të pamohueshme në shërbim të përhapjes së vlerave të lirisë dhe demokracisë".



Vendi ku ndodhi atentati mafioz



Shkodra si Palermo, 9 persona të vrasë në 9 muaj, asnjë i arrestuar

SHKODËR - Ekzekutimi në atentat i dy vëllezërve, Astrit dhe Brahim Bilali ditën e djeshme e ka çuar në 9 bilancin e të vrasëve gjatë harkut kohor të 9 muajve të fundit. Gjithçka nisi më 18 qershor të vitit që shkoi, kur u vra me plumb në kokë Mehdi Kavaja, pronar i një servisi. Kjo ngjarje u pasua me një nga atentatet më të rëndta të ndodhura vitet e fundit. Më 15 korrik 2018 u ekzekutuan në një atentat ish-oficeri i policisë, Boran Bërçana dhe bashkëjetuesja e tij, Silvi Ndoci. Ata u qëlluan në makinë në kohën kur do të zbrisnin, ku ndodhej edhe fëmija i tyre vetëm 2 vjeç. Edhe në këtë rast, autorët dhe motivet nuk dihen. Më 10 gusht 2018, Shkodra do të tronditej nga një tjetër vrasje mafioze. Viktimë mbeti Fatbardh Lici, i cili u qëllua nga një breshër automatiku gjatë kohës që po pinte kafe në një lokal në lagjen "Kiras". Ende edhe sot nuk ka të arrestuar apo një pistë konkrete, ku të jetë fokusuar puna e policisë. Prej 23 gushtit të 2018-ës, dy persona rezultojnë të zhdukur në Shkodër: Për fatin e Agron Mollajt dhe Gëzim Hysajt, dalje e nip mes tyre, nuk dihet asgjë dhe ka dyshime se ata mund të jenë vrasë. Më 1 shtator u vra Arjan Ferracaku, biznesmen. Ai po kalëronte pikërisht në pistën e hipizmit të familjes Bilali, bashkë me Asmer Bilalin. Më 14 nëntor, në tregun e lagjes "Rus" u vra Fatos Ferracaku, kushëri i Arjan Ferracaku. Ai u qëllua me disa plumba në kokë dhe trup, motivi ende dhe autorët ende edhe sot nuk janë zbuluar. Më 20 mars të këtij viti, në një tjetër ngjarje mafioze u vra Nard Polia, pronar i një bujtine në Theth. Policia arrestoi tre persona, të cilët mohuan autorësinë, ndërsa motivet ende nuk janë bërë publike.



VOLTANA ADEMI
Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi, ka folur në lidhje me vrasjen e dy vëllezërve Bilali në qytetin verior. Ademi tha se situata duhet të tmerrojë kryeministrin, ndërsa shtoi se Shkodra është nën mëshirë të larjes së hesapeve. "Vrasjet mafioze në Shkodër duhet të tmerrojnë të gjithë qeverinë. Këto vrasje të tipit mafioz duhet të tmerrojnë shtetin. Situata paraqitet shqetësuese", deklaroi ajo.



IZMIRA ULQINAKU
Ish-deputetja e Partisë Demokratike, Izmira Ulqinaku, ka reaguar për vrasjen e vëllezërve Bilali në Shkodër. Ulqinaku u shpreh se as në vitin 1997 nuk ka qenë kjo gjendje. Ulqinaku tha se Edi Rama e ka kthyer Shkodrën në skenë eksperimentale të kimit. Për të, pushteti i kimit po mbjell terror dhe pasiguria ka pushtuar jetën e qytetit verior. Ajo nënvizoi se Rama po ndjell frikë e tmerr në Shkodër.



LUÇIANO BOÇI
Ish-deputeti demokrat, Luçiano Boçi, ka reaguar përmes një statusi në "Facebook" për ekzekutimin e dy vëllezërve Bilali në Shkodër. Boçi u shpreh se Shkodra ngjan me një Palermo. Ai shtoi se Palermo është edhe Elbasani, Durrësi, Vlora e Tirana, e gjithë Shqipëria. Ai deklaroi se vendi udhëhiqet nga një organizatë kriminale, ndërsa akuzoi Policinë e Shtetit se s'ka vullnet për të zbardhur krimet të rënda.

Gjendet mes flakëve makina e vrasësve. Lleshaj: Ngjarja, për larje hesapësh

Përplasja mes bandave në Shkodër, ekzekutohen në atentat vëllezërit Astrit dhe Brahim Bilali

Babai dhe xhaxhai i ish-boksierit të Vllaznisë u qëlluan me breshëri kallashi afër banesës së tyre



Vrasja e dy vëllezërve, ministri Lleshaj shkarkon kreun e policisë së Shkodrës

Pas ngjarjes së rëndë në Shkodër, ku mbetën të vrarë dy vëllezërit Bilali, ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj, drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu si dhe drejtori i Policisë Kriminale, Tonin Vocaj kanë zbuluar në qytetin verior: Nga Shkodra, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, njoftoi shkarkimin e drejtorit të policisë në këtë qytet. Lleshaj u shpreh se për t'i dhënë një impuls të ri qytetit, sipas tij në krye të policisë së Shkodrës, në vend të Vehbi Bushatit do të vendoset Niko Brahimaj. "Për t'i dhënë qytetit një impuls të ri, kemi vënë në Policinë e Shkodrës Niko Brahimajn në vend të Vehbi Bushatit. Erdha në Shkodër për këtë arsye, por edhe për ngjarjen e rëndë të ndodhur. Vrasja në Shkodër është vrasje për larje hesapësh. Forcat e policisë po bëjnë maksimumin për ta zbardhur ngjarjen. Qytetarët nuk kanë pse të mos ndjehen të sigurt. Ne jemi në proces hetimi për këtë ngjarje, por edhe për ngjarjet të tjera. Shpresoj që të kemi sa më shpejt rezultate", ka thënë ministri.

SHKODËR

Përplasja mes bandave kriminale ka shkakuar dy viktimat e radhës në Shkodër. Paraditen e djeshme, kryeqendra e veriut të vendit u trondit nga një atentat mafioz, ku mbetën të vrarë Astrit dhe Brahim Bilali, përkatësisht 59 dhe 61 vjeç. Dy vëllezërit u qëlluan me breshëri kallashnikovi në afërsi të banesës së tyre, në lagjen "Kiras", e cila është një nga zonat më problematike në Shkodër. Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi në vendin e quajtur "Zooteknika" dhe se njëri nga viktimat është babai i Astmer Bilalit (ish-kampion boksi) i arrestuar në shtator të vitit që shkoi si pjesë e grupit kriminal "Bajri", në Shkodër. Bëhet fjalë për biznesmenin Astrit Bilali, i cili kishte në pronësi të tij një resort hipizmi. Menjëherë pas sinjalizimit për ekzekutimin e dy vëllezërve Bilali, forcat të shumta policore si dhe Forcat e Ndërhryjes së Shpeshhtë (FNSH) shkuan në vendngjarje dhe nisën hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-prake, blutë pohan se dy viktimat u qëlluan për vdekje nga persona ende të paidentifikuar nga një automjet tip "Benz" me targa AA 369 RV, që dyshohet se janë false. Pak minuta pas atentatit të dyfishtë, automjeti u gjet mes flakëve vetëm pak metra larg zonës ku u vranë Brahim dhe Astrit Bilali, në një rrugicë të lagjes "Guerrile". Ndërkaq, burime pranë grupit hetimor pohan se vrasja dyshohet të jetë hakmarrje. Kjo për faktin se viktimat kanë lidhje me një ngjarje tjetër të rëndë, të ndodhur më 1 shtator të vitit që shkoi, ku mbeti i vrarë Arjan Ferracaku teksa kalëronte në resortin e kuajve të Astrit Bilalit. Nga ana



Vëllezërit e vrarë në atentat, Brahim dhe Astrit Bilali



PISTA E HETIMIT

Sipas burimeve të mësipërme, pista kryesore ku po hetohet ka lidhje me ngjarje të tjera kriminale të ndodhura në Shkodër dhe konkretisht, ajo e larjes së hesapeve mes grupeve rivale. Në lidhje me vrasjen e dyfishtë janë marrë në pyetje 20 persona me precedentë penalë. Policia shpreson të sigurojë prova në makinën që dyshohet se u përdor nga vrasësit dhe që u gjet mes flakëve. Mësohet se forcat zjarfikëse arritën të shuanin flakët dhe fatmirësisht mjeti është djegur pjesërisht.

tjetër, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, dje deklaroi nga Shkodra se vrasja e dyfishtë është për larje hesapësh dhe se forcat e policisë po bëjnë maksimumin për ta zbardhur ngjarjen.

ATENTATI ME DY TË VRARË

Atentati i dyfishtë ku humbën jetën dy vëllezërit Bilali ndodhi rreth orës 09:45. Mësohet se viktimat kanë qenë duke shkuar tek e motra, që jetonte shumë pranë tyre, kur u qëlluan me breshëri automatiku nga një automjet, duke mos i lënë mundësi të reagonin. Ata kanë mbetur të vdekur në vend si pasojë e plumbave të marrë. Dyshohet se kanë qenë dy persona që kanë qëlluar për vdekje Astrit dhe Brahim Bilalin. Menjëherë pas kriminit, autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i

ngjarjes me një automjet me targa AA369RV. Sipas bluve, targa e automjetit të përdorur nga autorët dhe që u gjet pjesërisht i djegur afër vendit të ngjarjes dyshohet se janë false dhe se ato i përka-sin një automjeti tjetër, "Volkswagen Polo". Në lidhje me ngjarjen e rëndë ka reaguar zyrtarisht policia. "Me datë 30.03.2019, rreth orës 09:45, në lagjen "Guerrile" në vendin e quajtur "Zooteknika", nga persona ende të paidentifikuar janë vrarë me armë zjarri shtetasit A.B., 59 vjeç dhe B. B., 61 vjeç (vëllezër). Shërbimet e policisë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë vënë në ndjekje të autorëve, të cilët pas ngjarjes janë larguar me një automjet, i cili është gjetur duke u djegur në një rrugicë në bren-dësi të lagjes ku ka ndodhur ngjarja. Në ndihmë të Policisë

DY ATENTATORËT

Mësohet se viktimat kanë qenë duke shkuar tek e motra, që jetonte shumë pranë tyre, kur u qëlluan me breshëri automatiku nga një automjet, duke mos u lënë mundësi të reagonin. Ata kanë mbetur të vdekur në vend si pasojë e plumbave të marrë. Dyshohet se kanë qenë dy persona që kanë qëlluar për vdekje Astrit dhe Brahim Bilalin. Menjëherë pas kriminit, autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes me një automjet me targa AA369RV.

së Shkodrës janë vënë forcat FNSH Shkodër, ku janë ngritur pika kontrolli, si dhe po bëhet krehja në një perimetër të gjerë të zonës, me qëllim kapjen e autorëve. Gjithash-tu, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është nisur një grup i posaçëm me ekspertë dhe drejtues të Policisë Kriminale dhe asaj të Rendit për t'u bashkuar grupit hetimor të ngritur për zbardhjen e kësaj ngjarjeje", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë, policia kërkon bashkëpunimin e qytetarëve që çdo informacion sado të vlefshëm që mund të kenë të njoftojnë në numrin 112, ose në numrin 0 69 410 2147, duke i garantuar ruajtjen e plotë të anonimitetit.

HETIMET

Pas atentatit mafioz që tronditi Shkodrën, policia dhe

prokuroria kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes si dhe identifikimin e vënien në pranga të autorëve të kriminit. Sipas burimeve të mësipërme, pista kryesore ku po hetohet ka lidhje me ngjarjet të tjera kriminale të ndodhura në Shkodër dhe konkretisht, ajo e larjes së hesapeve mes grupeve rivale. Në lidhje me vrasjen e dyfishtë janë shë-qëruar dhe marrë në pyetje 20 persona, me të cilëve edhe me precedentë penalë. Policia shpreson të sigurojë prova në makinën që dyshohet se u përdor nga vrasësit dhe që u gjet mes flakëve. Mësohet se forcat zjarfikëse arritën të shuanin flakët dhe fatmirësisht mjeti është djegur pjesërisht. Policia kriminale pritet të gjejë gjurmë në makinë, të cilat do të mund të çojnë në identifikimin dhe kapjen e ekzekutorëve të vëllezërve Bilali.

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Moisiu e Meidani: T'i thërrasin mendjes! Palët të ulen e të dialogojnë

Valentina Madani

Dy ish-presidentët Rexhep Meidani dhe Alfred Moisiu mbështesin idenë se Presidenti i Republikës duhet të ndërhyjë për të zgjidhur krizën në vend, ndërsa bëjnë apel që palët politike të gjejnë zgjidhje dhe të mos i vendosin fitilat situatës. Moisiu dhe Meidani mendojnë se për zgjidhjen e krizës politike në vend për shkak të djegies nga opozita të mandateve, duhet të angazhohet kreu i shtetit. Moisiu dhe Meidani kërkojnë ndërgjegjësime të klasës politike për reformat zhvilluese dhe integruese të vendit. "Mendoj se Presidenti aktual, Ilir Meta duhet të ndërhyjë. Kështu nuk mund të ecet përpara. Sesi e bën ndërhyrjen dhe tenton ta zgjidhë ngërçin politik, këtë e di Presidenti Meta. Klasa politike duhet të ndërgjegjësohet. Duhet të ndërhyjnë. Është e drejtë e tij si do të vendosë, por klasa politike duhet të ndërgjegjësohet, sepse kështu nuk mund të ecet më përpara", - deklaroi z.Moisiu. Për ish-kreun e shtetit, Rexhep Meidani, zgjidhja e krizës është në tavolinë. "Teorikisht jam pro për t'u mbledhur kjo klasë politike dhe për ta diskutuar zgjidhjen e krizës. Mirëpo, praktikisht kjo varet nga klasa politike. Ndërsa për djegien e mandateve nga opozita, mendoj se është vendim in-exremis. Nuk duhet futur fitili në zjarr. Zgjidhja është në tavolinë. Palët duhet të ulen", u shpreh ish-kreu i shtetit shqiptar, Rexhep Meidani. Edhe pse e quan ekstrem, vendimin për të djegur mandatet, Meidani, thotë se tashmë zgjidhjen e krizës politike në dorë e ka mazhoranca. "Vendimmarrja kryesore është e asaj që qeveris. Nëse gjykon që mund të kalojë në zgjedhje të parakohshme, vendimmarrjen e merr kjo klasë politike, por në gjykimin tim të gjithë opsionet janë në tavolinë", deklaroi ish-presidenti Meidani. Deklaratat e ish-presidentëve erdhën pas konferencës së lidershit ballkanik, e cila në qendër të diskutimeve kishte adresimin e situatës aktuale në vend dhe prezantimi i një vizioni për zhvillim të qëndrueshëm. Presidenti Ilir Meta me datën 20 mars kërkoi nga palët përgjegjësimëri për zgjidhjen e krizës, z.Meta kërkoi refleksim dhe ndërhyrje urgjente të të gjitha palëve për të shmanjur tensionet. "Nxis refleksimin e të gjithëve për t'u dhënë fund sjelljeve polarizuese e përjashtuese përpara se dëmet e kësaj krize të rrezikojnë çdo arritje të këtyre

Kriza, apeli i ish-presidentëve: Meta të negociojë për zgjidhjen

Meidani: Nuk duhej futur fitili në zjarr



Ish-presidentët Alfred Moisiu dhe Rexhep Meidani

ALFRED MOISIU

"Mendoj se Presidenti aktual, Ilir Meta, duhet të ndërhyjë. Kështu nuk mund të ecet përpara. Sesi e bën ndërhyrjen dhe tenton ta zgjidhë ngërçin politik, këtë e di Presidenti Meta. Klasa politike duhet të ndërgjegjësohet. Duhet të ndërhyjnë. Është e drejtë e tij si do të vendosë, por klasa politike duhet të ndërgjegjësohet, sepse kështu s'mund të ecet më përpara", - tha z.Moisiu.

REXHEP MEIDANI

"Teorikisht jam pro për t'u mbledhur kjo klasë politike dhe për ta diskutuar zgjidhjen e krizës. Mirëpo, praktikisht kjo varet nga klasa politike. Ndërsa për djegien e mandateve nga opozita, mendoj se është vendim in-exremis. Nuk duhet futur fitili në zjarr. Zgjidhja është në tavolinë. Palët duhet të ulen", u shpreh z.Meidani.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, djenë Durrës

Marrëveshja për zgjedhjet lokale, kandidatët do verifikohen nga prokuroria

Hetimi i krimeve elektorale, financimi i fushatës zgjedhore për lokalitetet 2019, pastërtia e figurave për kandidatët si dhe parandalimi i krimeve elektorale, përfshi shitblerjen e votës, kanë ulur në tryezë Prokurorinë e Përgjithshme dhe KQZ-në, duke firmosur një marrëveshje mes tyre. Përmes saj, Arta Marku e Klement Zguri angazhohen për të ndërtuar grupe pune, të cilat do të monitorojnë zgjedhjet për të goditur e parandaluar çdo shkelje të ligjit zgjedhor. "Report TV" raporton se financimi i fushatave elektorale, blerja e votave, kërcënimi i zgjedhësve si dhe pastërtia e figurës së kandidatëve për zgjedhjet lokale do të kalojnë në filtrin e prokurorisë. Kjo marrëveshje është nënshkruar ndërmjet KQZ-së e prokurorisë për të rritur integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, nisur edhe nga e shkuara, ku krimet



elektorale kanë qenë të pranishme. Por, si do të zbatohet kjo marrëveshje në terren? Nëpërmjet personave të kontaktit, prokuroria e KQZ-ja angazhohen të "trajnojnë aktorët e përfshirë në këtë proces, të zhvillohen fushata sensibilizimi nga KQZ-ja, të konstatohen aktet korruptive dhe financimi i fushatave me para të paligjshme, të analizohen formularët e vetëdeklarimit të efekt të ligjit të dekriminalizimit". Ndërsa, prokuroria angazhohet që me strukturën e saj të hetimit t'u japë për-

parësi rasteve të denoncuar dhe referuara për krimet elektorale. KQZ-ja e prokuroria pritet të krijojnë edhe aplikacione, të cilat do t'u lehtësojnë subjekteve apo qytetarëve denoncimin e krimeve elektorale duke identifikuar zonën, apo qendrën e votimit ku konstatohet shkelja e ligjit. Kjo marrëveshje është nënshkruar edhe me praninë e OSBE-së, një institucion i cili asiston Shqipërinë për zbatimin e ligjit dhe monitorimin e certifikimit e zgjedhjeve.

tri dekadave", - u shpreh Presidenti Ilir Meta. Madje, presidenti tha se është i gatshëm të sakrifikojë jetën e tij, duke u vetëvurrë në mënyrë që vendi të dalë nga kriza politike, që sipas tij mund të thellohet edhe më tej. Do ta bënte këtë veprim të njëjtë si

presidenti i Kilit në vitet '70-'73, Salvador Allende, që u vetëvurrë si sakrificë ekstreme kundër instalimit në pushtet të një junte ushtarake. Me mesazh të drejtpërdrejt ndaj kryeministrit Rama dhe liderit opozitar Basha, Meta deklaroi se ata po sakri-

fikojnë vendin në një krizë gjithnjë e më të thellë për karrigen e tyre. Zgjidhja është vetëm përmes dialogut - tha Meta - dhe nëse kjo arrihet paraprakisht, atëherë ai është i gatshëm të lërë të lirë edhe vendin e presidentit, për t'i hapur rrugë zgjidhjes.

Kryemadhi: Mungesa e subvencioneve, dëm të jashtëzakonshëm për fermerët

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, ishte në fermën bujqësore të një çifti të ri në njësinë administrative Golem të Lushnjës, të cilat sapo kanë përfunduar studimet universitare, kanë vendosur të kthehen në fshat për të investuar në bujqësi. Kryemadhi gjatë takimeve u njoh nga afër me problematikat e hasura prej fermerëve, si dhe me sfidat me të cilat këta të fundit përballen. Duke u ndalur tek ulja e TVSH-së si dhe të gjitha problematikat e fermerëve, Kryemadhi theksoi se kjo gjë ka ardhur për shkak të mungesës së vizionit dhe dëshirës së qeverisë për të cuar përpara sektorin e bujqësisë. Kryemadhi bëri të ditur para fermerëve se në momentin që LSI-ja do të vijë në pushtet, ajo do të ketë prioritet bujqësinë dhe do ta mbështesë atë përmes skemave financiare. "Bujqësia shqiptare jo vetëm që vuan dhe jo vetëm që vajton në trishtimin e saj, por çdo ditë e më shumë mundësitë për shqiptarët për të krijuar hapësira të reja punësimi dhe për të zhvilluar ekonominë bëhen më të vështira. Mungesat e subvencioneve janë ato, të cilat i kanë dhënë një dëm të jashtëzakonshëm bujqësisë. Ajo që të bën përshlyetje sot në bujqësinë shqiptare është mungesa e vizionit, është mungesa e dëshirës së institucioneve të shtetit për të ecur më përpara. Ne duhet të bëjmë shumë. Ne duhet t'u ofrojmë shumë të rinjëve dhe të rejave që të kenë mundësinë për të zhvilluar bujqësinë shqiptare, për të zhvilluar blegtorinë shqiptare, sepse nëpërmjet saj, ne mund të zhvillojmë vendin dhe mund të zhvillojmë shumë oportunitete të reja për vende të reja pune, për ekonomi më të fortë dhe për ta zhvilluar me tej Shqipërinë ashtu siç e meritojmë", tha zj.Kryemadhi. Ajo garantoj se LSI-ja do të ketë mbështetje prioritare për bujqësinë si një sektor që krijon punësim dhe të ardhura direkte në familjet shqiptare.





"Lider pa hallate", kreu i PD: Sa herë që merret me pjesët e mia të trupit, e ka një hall...

Basha i përgjigjet Ramës: Vjedh 100 mijë euro në orë

"Kryeministër hajdut, kloun, majmun..."

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, para durrsakëve të shumtë akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se u vjedh shqiptarëve 100 mijë euro në orë. Një ditë pas kryeministrit Edi Rama, lideri demokrat zhvilloi një takim me banorët e Durrësit nga ku akuzoi kryeministrin për lidhjet me krimin dhe korrupsionin. "Klouni që erdhi dje (të premtën) këtu te ju, nuk ishte kloun, ai është hajduti më i madh në historinë e Shqipërisë, që fshihet pas shakave bajtate dhe fut duart ditë për ditë në xhepat tuaja. Vetëm sipas të dhënave zyrtare, në vetëm 2 vite Edi Rama ka kullufitur afro 2 mld euro nga taksat e shqiptarëve. 2 mld euro i bie që ka vjedhur 2 vitet e fundit 2.4 mln euro në ditë, 100 mijë euro në orë është tarifa e estradës së Edi Ramës, por nuk është estradë, është tallje me ju", tha z.Basha. Ai shtoi më tej se sa herë që Rama bën shaka, apo merret me pjesët e trupit të tij, e bën sepse sipas Bashës, ai ka një hall, "të fshehtë atë që nuk e fsheh dot më kurrë, që bota e tregon me gisht si kryehajdutin e Ballkanit". "Dua t'u bëj thirrje edhe socialistëve të ndershëm që ja zbrazën sheshin, edhe punonjësit e administratës që rrinin kokullur, edhe ndonjërit që qeshte si dele me shakatë e kripura të kryegastorit. Mos qeshni o dele, se çdo shaka ju kushton 100 mijë euro në orë. Kjo është fatura e Ramës për popullin shqiptar. Sa herë del para jush dhe ngërdheshet si majmun, sa herë që del para jush dhe tallet me opozitën, apo merret me pjesët e mia të trupit, sa herë del para jush ka një hall të madh, jo vetëm të fshehtë vjedhjen, por të fshehtë atë që nuk e fsheh dot kurrë, atë që bota e tregon me gisht si kryehajdutin e Ballkanit, që shqiptarët do ta shporin. Dje halli i tij ishte gjigant. DASH e tha qartë atë që çdo shqiptar e di", theksoi z.Basha. Nga sheshi para Bashkisë së Durrësit, kreu i opozitës apeloj se largimi i Edi Ramës është emergjencë kombëtare. "Gjushi i krimin e ka rritur me 40% çmimin e ujit në Durrës. Klouni që erdhi dje para jush nuk ishte



AKUZA
"Sa herë ta shikoni duke u shtirur si një kloun, kujtohuni që nuk kenë një kloun përpara, as thjesht një të sëmurë psikik, por hajdutin më të madh që ka parë ky vend. 100 mijë euro në orë është fatura e çdo shqiptari, 100 mijë euro në orë paguan ky popull për estradën e shpifur të Edi Ramës. A është kjo fatura që duhet të vazhdojmë të paguajmë?", deklaroi kreu i PD-së.

Dule: Karamelot nuk i shërbejnë Ramës si kamerdare shpëtimi

Kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, i cilësoi deputetët e rinj të opozitës si kalimtarë, pasi nuk do të japin asnjë kontribut për vendin. Nga Korça, Dule tha se as Karamelo, as pjesa tjetër e deputetëve të rinj nuk do të shërbejnë si kamerdare shpëtimi për kryeministrin Edi Rama. Sipas Dules, opozita është mëse e vendosur për të larguar nga qeveria kryeministrin Edi Rama dhe se ka totalisht mbështetjen e qytetarëve. "As Karamelo, as të ngjashmit e tij, nga çdo drejtim që mund t'i bashkëngjiten Ramës nuk mund të shërbejnë si kamerdare shpëtimi. Janë thjesht fenomene, që në jetën politike të çdo vendi janë kalimtarë dhe nuk mund të kenë asnjë kontribut dhe asnjë domethënie. Rrjedhimisht, duhet të jemi të gjithë më të vendosur se kurrë që t'i përgjigjemi kërkesës popullore, të largohet Rama, të largohet qeveria e tij. Qytetarët duhet të kenë të drejtën që ka çdo qytetar i vendeve të lira dhe të civilizuara, të drejtën e votës. Vota të mos blihet me thasë me miell, me shlyerje të detyrimeve të OSHE-së, të ujesjellësit, por të shprehin vullnet politik", tha z.Dule. Duke u ndalur te zgjedhjet lokale, Dule u shpreh se Rama duhet mëshiruar, pasi tragjikomedia e tij personale rrezikon të kthehet në tragjedi të të gjithë vendit.

Berisha, Dakos: Gjush, të flaku nëntoka, ike me zemër të thyer

Ish-kryeministri Sali Berisha bëri dje të ditur se Vangjush Dako kishte përgatitur një antimiting ndaj kryeministrit Rama gjatë vizitës së tij ditën e premtë në Durrës, sipas tij, me shpresën se do të rikandidonte për Durrësin, por se nuk ia arriti dot qëllimit. Berisha shkruan në "Facebook" se gjendjen shpirtërore të Dakos e shpreh mjaft mirë poeti amerikan, Edgar Allan Poe, në poemën e tij "Korbi". Për Berishën, Dako iku me shpirt të ndezur dhe me zemër të thyer. "Gjushi përgatiti me shuma të mëdha antimitingun e Ramës, i bindur se ky i fundit do ta shpallte kandidaturën e tij për kryetar bashkie të Durrësit, nëlloj siç bëri me Lal Plehun dy ditë më parë në Tiranë. Por, për shkak të një urdhri misterioz që u lëshua në distancën Ti-



ranë-Durrës, Gjushi dje publikisht në vend të lavdisë mori poshtërimin. Antimitingun erdhi si aktakuzë, pretencë jo me fjalë, por me vepër ndaj tij. Kështu, ai u kthye në shtëpi me shpirt ende të ndezur, por me zemër jo të thyer, siç thotë poeti në poemën e tij, por të cilfosur e madje të plasur: Në të vërtetë dje Gjushit i vinin ndër mendje jo vargjet e poetit, përjetimet e dhimbshme të studentit për hireplotën Elinore, por psherëtimat e

plakut të Heminguejt tek shihte peshkun që po ia shqyqin peshkaqenët (Lal Plehurat, Taulant Begot, Ardian Akrabaja etj., etj.) dhe përsëriste me vete 'ah peshk, ti që je gjysmë peshk, sikur të ishe edhe një herë peshk! Gallanos... Gallanos!". Pijë detin Gjush, të flakën dhe të poshtëruan ata të nëntokës. Rahmetli qofsh edhe ti! Amin!", shkruan z.Berisha në "Facebook".

Zgjedhjet, Agron Duka: Gati të kandidoj në Durrës

Agron Duka, kryetari i Partisë Agrare Ambientale, është i gatshëm të kandidojë përballë socialistëve për Bashkinë e Durrësit. "Nuk është ndonjë dëshirë të cilën unë e aspiroj personalisht, por nëse më kërkohet, mund të bëj sakrificë, por kjo është temë jashtë realitetit. Tema kryesore është: A do ketë zgjedhje normale, do hyhet në zgjedhjet e qershorit me Edi Ramën? Unë them jo", tha z.Duka. Ai përsëriti se zgjedhjet e lira mund të bëhen vetëm me një qeveri tranzitore dhe pa Edi Ramën kryeministër, për të cilat ai thotë se opozita po përgatitet. Lidhur me krizën në vend, Agron Duka shprehet se padyshim që zgjidhja e saj do të duhet të vijë nga vetë partitë politike, por ku nuk mund të mungojë edhe ndërhyrja e ndërkomëtareve. "Në këto kushte, zgjidhja e kësaj krize kërkohet të mazhoranca dhe të një individ, Edi Rama. Kërkesa e vazhdueshme është se nuk mund të shkojmë në zgjedhje parlamentare apo lokale me Ramën kryeministër", tha Duka.

kloun, por po hajduti më i madh në Shqipëri, që fshihet pas batutave të rëndomta. Për dy vite ai ka grabitur 2 milionë euro nga taksat tuaja. Ai i vjedh 7-fish shqiptarët, popullin më të varfëruar të Europës", theksoi z.Basha. Kreu i PD-së komentoi edhe raportin e publikuar nga DASH një ditë më parë. Ai tha se në raport SHBA-të shkruajmë të zezë mbi të bardhë se Shqipëria është strehë e krimin. "SHBA treguan të zezë mbi të bardhë

të vërtetën që dinë të gjithë shqiptarët. Shqipëria, strehë e krimin dhe kjo e gjitha për shkak të korrupsionit të përhapur. E ka fjalën për Edi Ramën, Saimir Tahirin, Fatmir Xhafajn". Ai paralajmëroi: "Po fryn era e ndryshimit dhe era e lirisë. Vëllezër dhe motra, po fryn era e shpresës për çdo familje shqiptare. Ditën e djeshme përgjegjësi për gjendjen ku është sot Shqipëria përsëriti një shtafje të shtëmtuar. Dje isha në një takim me disa miq,

në shtëpinë futbollistit Ali Mema dhe biseda e parë që qytetarët hapin janë hallat dhe problemet për shkak të faturave të larta. Populli më i varfër paguan naftën njësoj si populli më i pasur: Qindra biznese të vogla kanë përfunduar për kafshatën e bukës, sepse taksat e Gjushit të Ramës janë më të larta. Ata detyrohen të shkojnë jashtë shtetit sepse fitojnë më shumë si pastrues në Gjermani sesa si biznesmenë apo profesionistë në Shqipëri".

RAPORTI I DASH PËRPLASJA

Ministri: DASH jo raport destabilizues, inkurajues për reformat

Raporti i DASH për Shqipërinë, Rama: Rrugëhumburit e keqpërdorën

Cakaj: Që kemi kanabis nuk është e fshehtë kozmike

Kur Rama akuzoi opozitën për keqpërdorimin që sipas tij po i bëjnë raportit të Departamentit të Shtetit për Shqipërinë për vitin 2018. Z.Rama reagoi dhe ndaj të gjitha kritikave dhe akuzave me të cilat u pasua publikimi i raportit, që konstatonte Shqipërinë si transit për drogat e forta dhe "bazë operacionesh për grupet e krimi të organizuar që vepron në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut". "Të pamësuar të lexojnë, të paaftë të kuptojnë dhe të padëshiruar të shohin e të flasin tjetër gjë, përveç të keqes që u dëshiron syri e u nxjerr goja, rrugëhumburit e politikës e të medias e keqpërdorën edhe këtë raport si gjithçka tjetër, për të tërhequr zvarrë publikun në llumin e fjalëve të tyre", shkruan Rama në "Facebook". Më herët qeveria përmes ministrit në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, e cilësoi dokumentin pasqyrë realiste për Shqipërinë dhe inkurajues për reformat që vijnë. Sipas tij, raporti duhet lexuar qartë, pasi ndryshe nga vendet e rajonit, ka një performancë më pozitive. Sipas ministrit Cakaj, raporti i DASH nuk ndikon në vendimin e 30 qershorit për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ministri në detyrë i Europës dhe Punëve të Jashtme, në një konferencë për mediat, deklaroi se raporti është realist për Shqipërinë dhe njëkohësisht inkurajues për punën dhe reformat e ndërmarra nga qeveria. "Raporti është një pasqyrë realiste për Shqipërinë, inkurajues për reformat që po ndodhin çdo ditë në Shqipëri. Nënvizion bashkëpunimin e qëndrueshëm midis Shqipërisë dhe SHBA-ve. Thëkson faktin se Shqipëria ka arritur rezultate thelbësore ndaj luftës kundër krimi të organizuar dhe kultivimit të drogave, me qëllim antarësimin në BE, pra s'ka ngadalësim, por përparim. Raporti duhet lexuar qartë dhe pa komplekse, ashtu siç është", deklaroi z.Cakaj. I ndalur të çështja e kanabisit, heroinës e kokainës, Cakaj përmendi se kjo gjë dihet dhe se deri më tani, Shqipëria ka bërë përparim sa i takon luftës ndaj këtij fenomeni. "Cilësohem si vend burimi për kanabisin dhe vend transit për kokainë dhe heroinë, të udhëhequr nga grupe kriminale. Sasia e drogës së kapur gjatë vitit 2018 është domethënëse dhe vjen si një përpjekje për integrimin. Shqipëria është vend origjine kanabisi dhe kjo është fshehtësi kozmike, por nga ana tjetër po e minimizon këtë



EDI RAMA

"Të pamësuar të lexojnë, të paaftë të kuptojnë dhe të padëshiruar të shohin e të flasin tjetër gjë, përveç të keqes që u dëshiron syri e u nxjerr goja, rrugëhumburit e politikës e të medias e keqpërdorën edhe këtë raport si gjithçka tjetër për të tërhequr zvarrë publikun në llumin e fjalëve të tyre", shprehet z.Rama.

GENT CAKAJ

"Nuk është e fshehtë kozmike që jemi një vend origjine për kanabisin. Korrupsioni në vendin tonë është fakt i pamohueshëm dhe i takon kësaj qeverie të marrë përgjegjësitë. Ky raport nuk duhet të bëjë një arsye për skandalizim. Shqipëria e sotme nuk është ajo e 2013-ës", u shpreh ministri në detyrë.

Raporti, PD: Rama bëri lojë të rrezikshme, 6 faktet që nuk i mbulon dot

Lojë të rrezikshme propagandistike e cilësoi dje PD-ja leximin që qeveria i bëri raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit. "Realiteti që Rama kërkoi ta shesë si normalitet nuk mund të mbulohej me propagandën e neveritshme që synon të bëjë shqiptarët për budallenj. Fjalja e parë e raportit të DASH se 'Shqipëria është burim në rritje për kokainën dhe heroinën', është përfshirë për herë të parë këtë vit në raport. Kushdo që e krahason me raportin e 2018-ës do ta konstatojë këtë", deklaroi ish-deputeti Sallianji. Sipas tij, bashkëpunimi dhe mbrojtja nga qeveria i ka dhënë mundësi krimi të organizuar dhe grupeve të strukturuar kriminale që të forcohen, duke kthyer Shqipërinë në bazë operacionale për organizatat e krimi të organizuar që vepron në SHBA, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën Latine. Sipas PD-së, Rama nuk mund të fshehtë faktet se: "Shqipëria është shndërruar në një vend transit në rritje për kokainën dhe heroinën, që komandohej gjerësisht nga elementë të krimi të organizuar. Droga e sekuestruar dhe arrestimet janë rezultate nga bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe presioni në rritje ndërkombëtar. Evidentohet ndërtimi i laboratorëve të përpunimit të kokainës dhe të heroinës në Shqipërinë Qendrore dhe Veriore. Korrupsioni i përhapur gjerësisht, në çdo nivel të qeverisjes kufizon efektivitetin e luftës ndaj drogës dhe ushqen një mjedis, ku trafikantët e drogës kanë gjerësisht mundësinë të vepronin pa u ndëshkuar. Shqipëria evidentohet si bazë për veprimtarinë e organizatave kriminale që vepronin në SHBA, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut. Qeveria e Shqipërisë nuk ka bërë një progres domethënës lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe krimeve financiare".

fenomen. Thuhet po ashtu se ka rezultate domethënëse në luftë me këtë fenomen. Pra, nuk kemi dorëzim institucional para narkotrafikut. Sa për heroinën dhe kokainën, nuk kemi të bëjmë me e një ndër marrje kriminale shetërore. Shqipëria ka pasur

rritje të rasteve të kapjes së kokainës, që kalon transit nëpër Shqipëri. Pra, konfirmim i asaj që thashë, ka rritje të sigurisë ndërkufitare, performancë pozitive për kapjen e drogës", u shpreh ministri në detyrë, Gent Cakaj.



BRITISH AMERICAN
TOBACCO

British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njoftim se duke filluar nga data 1 prill 2019, çmimet maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

Nr	MARKA	Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
1	Dunhill FC 7 mg	330
2	Dunhill FC 4 mg	330
3	Kent HD Neo	300
4	Kent HD Infina	300
5	Kent Nanotek (Infina)	300
6	Lucky Strike NFF King Size 6 mg	250
7	Lucky Strike NFF King Size 4 mg	250
8	Lucky Strike Double Capsule Wild	250
9	Lucky Strike NFF Demislms 6 mg	230
10	Lucky Strike NFF Demislms 4 mg	230
11	Rothmans Leggera	250
12	Rothmans of London (Blue)	220
13	Rothmans of London (Sky Blue)	220
14	Rothmans of London Demi 6mg	200
15	Rothmans of London Demi 4mg	200
16	Eva Slims	200

*Çmimet shprehen në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.

Tirane, Rr: "Kavajes", ish Kombinati Ushqimor

web: www.bat.com

office phone: +355 (0) 42 255084

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të anulohet ndërtimi i dy HEC-ve të parashikuara për t'u ngritur në lumin Urakë, në zonën e Kurbneshit. Vendimin e ka bërë të ditur ministrja Belinda Balluku gjatë një dëgjese publike që zhvilloi me banorët e kësaj zone, të cilët shqetësimin e tyre sa i takon ndërtimit të këtyre dy HEC-ve e kishin adresuar në platformën e bashkëqeverisjes "shqipëriaqëduam.al". Balluku tha se qeveria është e

Balluku me banorët e Mirditës: Anulohet ndërtimi i dy HEC-ve në lumin Urakë

ndjeshme ndaj kërkesave të komunitetit dhe se tashmë kanë nisur procedurat për prishjen e kontratave për ndërtimin e dy HEC-ve. Ministria theksoi se zona në fjalë është një zonë e mbrojtur dhe në të nuk do të lejohet asnjë ndërtim. "Qeveria është shumë e ndjeshme ndaj kërkesave të komunitetit dhe duke qenë se ajo zonë është shpallur e mbrojtur, këtu nuk do të lejohet ndërtimi i këtyre dy HEC-ve. Kjo është një zonë e mbrojtur, kështu që edhe në të ardhmen ju nuk do keni problematika të tjera", u shpreh Balluku. Ministria theksoi se qeveria ka në fokusin e saj nxitjen e investimeve, por pa rënë ndesh me interesat e qytetarëve. "Ne e nxisim zhvillimin e ekonomisë, i mbështesim in-

vestitorët, por asnjëherë kur këto investime bien në kundërshtim me kërkesat, apo me të mirën e komunitetit", theksoi Balluku. Ministria u bëri thirrje banorëve që për shqetësimet që ata kanë t'i drejtohet platformës së bashkëqeverisjes, duke sjellë në vëmendje faktin që shqetësimi që ata adresuan për HEC-et mori zgjidhjen e duhur. Duke iu

përgjigjur shqetësimit të banorëve për projektet e tjera të HEC-ve që janë projektuar në lumin Urakë, ministrja Balluku theksoi: "Uraka



është e Mirditës. Uraka nuk është e askujt tjetër. Zonat e mbrojtura do të mbrohen nga qeveria shqiptare, por edhe nga banorët".

është e Mirditës. Uraka nuk është e askujt tjetër. Zonat e mbrojtura do të mbrohen nga qeveria shqiptare, por edhe nga banorët".

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, formulari tip dhe dokumentet që duhen dorëzuar

Të gjithë pronarëve që u është toka nga ndërtime pa leje dhe kanë një vendim për kompensim nga Këshilli i Ministrave, për të marrë kompensimin duhet të plotësojnë formularin tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfutuesve do të fillojë në datën 01.04.2019 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë", - thuhet në njoftimin e ATP-së. Pronari apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesëtip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Subjektet përfutues, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.

Kompensimi i pronave, ATP: Të hënën nis aplikimi

Kostoja e aplikimit, 2 mijë lekë

PRANIMI I KËRKESAVE
Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhrë të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërbllimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim in e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.


Faksimile e formularit tip

DOKUMENTET
Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesëtip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit për dëshmitë e trashëgimive të

lëshuara nga gjykata, për testamentin e bërë me akt material të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

- ### DOKUMENTET
1. Kërkesa-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, e plotësuar sipas rubrikave.
 2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt material të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi (në rast se subjekti përfutues ka vdekur).
 3. Prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet.
 4. Vërtetimin origjinal i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e logarisë bankare dhe IBAN-in përkatës.
 5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
 6. Certifikatë familjare të kërkuarit/aplikuesit.
 7. Mandatpagesa për shumën 2 000 lekë për çdo aplikim të veçantë.

KERKESA
Pronari apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesëtip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.



DPSHTRR: Nga 8 prilli, aplikimi 'online'

Duke nisur nga data 8 prill, të gjitha subjektet mund të aplikojnë 'online' për Certifikatë për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Udhëtarëve (të rastit). Njoftimin e ka bërë të ditur Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas të cilës kjo do të lehtësojë 169 subjekte dhe 436 mjete. Ndërkohë, kjo do të sjellë po ashtu edhe lehtësim të shërbimeve, kohës si dhe dokumenteve. Gjithashtu, në këtë kuadër subjektet do të përfitojnë verifikim në sistem dhe njehsimi i dokumenteve do të bëhet falas nga DPSHTRR. Sa i takon certifikatën, ajo mund të merret tashmë prej 8 prillit direkt nga 1-vjeçare në 5-vjeçare.

Bizneset me disa NIPT-e, Çurri: Procedura për çregjistrim dhe penalitetet

Individët që kanë më shumë se një numër unik të identifikimit të tatimpaguesit, NIPT, duhet që brenda datës 31 gusht të këtij viti të aplikojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit për të mbyllur NIPT-et e tjera dhe mbajtjen e një NIPT-i kryesor. Zv.drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, Xhavit Çurri, sqaron se çfarë duhet të bëjë subjekti në rastet kur nuk ka informacionin e duhur nëse NIPT-i i tij është mbyllur dhe penalitetet që duhet të paguajë. Nëse pas përfundimit të këtij afati konstatohet që një individ me të njëjtin numër të identifikimit personal nuk ka zbatuar këtë pikë, administrata tatimore do të aplikojë vlerësimin alternativ të tatimpaguesit sipas ligjit për procedurat tatimore. Kjo nëse synon t'i japë fund evazionit të konstatuar dhe praktikës me hapjen e mbylljen e NIPT-ve për të shmangur pagesën e detyrimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka informuar rreth 28 mijë tatimpagues për ndryshimet fiskale të fundvitet.

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve, tre muaj kohë për të plotësuar dosjen

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëshmërbllimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 1 mijë përfuttes, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfuttes, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e përfuttesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me "X" kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të

Lista e re / Ish-të përndjekurit, 1 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet dorëzohen në Ministrinë e Financave

sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëshmërbllimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rast

et kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në cer-

tifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimit të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Ligi parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzis-

tojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

TRASHËGIMTARËT QË MARRIN PARATË

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHIGIMIE	PROKURE
XHEVRIJE	MUZHAQI			X		V	V	P
SHEFKI	DASHI			V	V			V
HAZIS	DASHI			X				P
VITORI	KAPO			V				X
HARIKLA	BALTUVANI					X	V	V
GLIQERIA	ELEZI			V	V			
KRISANTHI	MELA			V	V			
VANGJEL	BALTUVANI			V	V		V	
TEKI	ILIAS			X				P
FEIM	ILIAS			V	V			
FLUTUR	QOSE			V	V			
DIANA	BARDHI			X	X			V
TATJANA	FRASHERI			V	V			
PEMBE	CAKO			V	V			
NINI	REXHEP			X				P
SHPETIM	GURRA			X	X			
MARK	KOLA			V	V			V
GYSTE	PALUCA			X	X			
NDOC	KOLA			X	X			
PRENG	KOLA			X	X			
		LULJETA	KOLA	X				P
		ARBEN	KOLA	X				P
		FLORA	KOLA	X				P
		DAVA	KOLA	X				P
SOFIJE	LAJTHIA					V	V	V
		EDMOND	LAJTHIA	V	X	X	X	
		ARDIANO	LAJTHIA	V	X			
		ILIR	LAJTHIA	V	X			
VERGINUSH	GJONA			V	X			
VELI	COLLAKU					X	X	V
		TRITAN	COLLAKU	X	X			P
		ANA	CHIKI	X				P
		MIRGETA	THACI	X				P
		MIMOZA	TUFA	X				P
		SAIMIR	COLLAKU	V	X			V
ALI	COLLAKU			V	X			
VALENTINA	BILISHAJ			V	X			
FATMIRE	KURTI			V	X			
AGUST	COLLAKU			V	X			
ENGJELL	COLLAKU			V	X			
LUMTURI	HIBO			V	X			
BUKURRIJE	MEHMETI			V	V			
HATIXHE	MEHMETI			V	V			
DIANA	MEHMETI					X	X	X
						V	V	V
HAJRRIJE	RUKAJ					V	V	X
MEM	RUKAJ			V				P
FERIDE	RUKAJ			V				P
XHIKE	RUKAJ			V				P
DIZZAR	RUKAJ			V	V			V
						V	V	V
SAFIJE	KULLA			X				P
MIDE	HIMA			X				P
FTINETE	MERA			X				P
DILAVËR	KULLA			V	V			V
						V	V	V
NEIME	JENISHERI					V	V	V
FEZILET	SPAHIU			X	X			
MINERVA	JENISHERI			X	X			
SANJË	JENISHERI			V	V			

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI TRASHIGIMIE	PROKURE
XHEVAHIRE	TAKE					V	V	V
		TATJANA	BERXOLLI	V	V			
BALLKEZE	SPAHIU					V	V	V
NADIRE	DOKO					V	V	V
		ILIR	DOKO	V	X			
		AGRON	DOKO	V	X			
		ADRIAN	DOKO	V	V			
MYZEJEN	HADERI					V	V	V
		FATOS	HADERI	V	V			
		VALENTINA	HOXHA	V	V			
		ADRIAN	HADERI	V	V			
		AGIM	PLAKU	V	V			
MIFARET	COMO			V	V			
AFERDITA	LAIAS			V	V	V	V	V
		GENTI	CANO	V	V			
		ALMA	CANO	V	V			
FATBARDHA	TAHIRI			V	V			
ERANDI	KOLA			V				P
DINORA	KOLA			V	X			
						V	V	V
ROZALIA	XHIMITIKU					X	V	V
GUIDO	XHIMITIKU					V	V	V
		EDMOND	XHIMITIKU	V				PI
		ROZALBA	PALI	V				PI
		SERXHO	XHIMITIKU	V	V			VI
KARMEN	XHIMITIKU			V	V			V
EZIO	XHIMITIKU			V	V	V	V	V
		MILTO	XHIMITIKU	V				P
		Aleksander Mat	XHIMITIKU	V				P
		Leonarda Klau	XHIMITIKU	V				P
FIDARIE	ZERIA			V	V	V	V	V
NAMIJE	CANI			V				P
XHAFIDE	CANI			V				P
						V	V	V
PRENA	GJOKA			V	V	V	V	X
NDREC	GJOKA			V	V			V
						V	V	V
SOFIJA	BELLO					V	V	V
MIHALLAQ	BELLO					V	V	V
		ORNELA	BELLO	V	X			ZV
		BRIKENA	BREGU	V	X			
THOMA	BELLO					V	V	V
KOÇO	BELLO					V	V	V
ASTRIT	SINANAJ					V	V	V
		SHEZAIR	SINANAJ			V	V	V
		FLORIE	ZYBERI	V				P
		GJINOVEFA	SINANAJ	V				P
		ZENEL	SINANAJ	V				P
		LINDITA	MUHAMETA	V				P
		LIJAN	SINANAJ	V				P
		MIMOZA	RRAPAJ	V				P
		LULZIME	SINANAJ	V	X			V
HYSEN	XEBA					V	V	V
		LAVDOSH	XEBA	V	V			
FADIL	XEBA			V	V			
MEHMET	XEBA			V	X			
NOVRUZ	XEBA			V	V			

DRITA	MYRTE	HAFIZE	MUSABELLI	V	V	V	V	P
		NADIOLA	PELLUMBI	V				P
		PETRIT	MYRTE	V				P
FESTIM	BEGOLLI	FARJIE	KOCIVERA	V	V	V	V	P
		ZHULJETA	KORKADHIE	V				P
		ALMA	MANESHI	V				P
		GEZIM	BEGOLLI	V				P
BUKURIJE	HOXHALLI			V				V
MYZEJEN	MANELLI			V	V			V
MANUSHAQE	AJINELLI			V				P
MERJEME	BRISKU			V				P
IFTADE	MANELLI			V	X			P
DILA	LLESHI				V	V	V	
NDUE	LLESHI				V	V	V	
		AGE	FRROKU	V				P1
		DAVA	CUNI	V				P1
		GJELE	GJURA	V				P1
		MARIANA	LEKA	V				P1
		MRIKE	BRUNGA	V				P1
		ZEF	LLESHI	V				P1
NIKOLL	LLESHI			V	V	V		P2
		NDREC	LLESHI	V				P2
		MARTE	LLESHI	V				P2
		MARE	LLESHI	V				V2
		GJERGJ	LLESHI	V	V			P1
LIZE	KUCAJ			V				P1
MARE	DODA			V				P1
PJETER	LLESHI			V	V			V1
EDMOND	DOKO					X	V	V
SIGFRID	DOKO					X	V	V
LIRI	BARDHI					V	V	V
		ORNELA	FEKANJII	V	V			V
		ILDA	BARDHI	V				P
		AGIM	BARDHI	V	X			
						V	V	V
FELLENXE	SPAHIA			V	X			
QEMAL	GURI			V	V	V	V	P
		PERLAT	GURI	V		V		P
		NEIM	GURI	V		V		P
		MURAT	GURI	V	V			P
		HENE	GURI	V				P
		LEONORA	DHIMA	V				
		SALI	GURI	V				
SHASHE	HOXHA				V	V	V	
ALBANA	HOXHA			V				P
BESNIK	HOXHA			V				P
HAZBIJE	HOXHA			V	X			
SHPETIM	HOXHA			V	V			V
SABRIJE	QESJA					V	V	V
ARJAN	QESJA			V				P
BUKURIJE	QESJA			V	V			V
DRITA	AHMETI				V	V	V	
		ALKETA	HASANI	V	X			
		NDRICIM	AHMETI	V	V			
FATMIR	QESJA			V				P
KUDRETE	QESJA			V				P
KUTIM	QESJA			V	X			
LIRI	SHEHU			V				P
NURIKA	HOXHA			V				P
PRANVERA	XHINDOLI			V	V			
SKENDER	QESJA			V				P
GANXHE	SHIROKA			V		V	V	P
KRISTINA	SHIROKA			V	V			
BIANKA	SHIROKA			V	X			
FILIP	SHIROKA			V	X			V
FATIME	JANGULLI					V	V	X
BANUE	FIKU					V	V	V
SHQIPE	MANJANI					V	V	P
PLEURAT	CACO					V	V	V
		SANIE	CACO	V	V			
		ARJANA	GUNBARDH	V	V			
VIRGINESHA	STAROVA			V	X			
NASTASI	VRETO			V	X			
GLIQIRI	MLZAKU			V	X			
GJERGJINA	BICKA			V	X			
AFROVITI	XEXO			X		V	V	V
ROMEO	XEXO			V	X			V
VOLTISA	NASLAZI			V	V			
THOMAIDHA	PARAVANI			V	X			
NURIHAN	KULLA					V	V	X
						V	V	V
NURJIE	GJYZELI			V				P
HYLLDYZE	KERTUSHA			V				P
EUGEN	GJYZELI			V	X			V
ZEGJINE	CERRIKU					V	V	V
VASFJIE	TAFI			X				P
BEHAR	CERRIKU			X				P
HURMA	LAMCJA			X				P
IKE	QORRI					V	V	V
		BLENDAR	QORRI	V				P
		ELONA	QORRI	V				P
		FLUTURA	TAFI	V				P
FERIT	CERRIKU			V	V			V
VARVARA	KENOUTI			V	V			
ANASTASIA	KENOUTI			V	V			
SPYRIDON	KENOUTI			V	V			
FLORJE	PASHAJ					V	V	V
EDMOND	PASHAJ			V				P
JETNOR	PASHAJ			X				P
ILIR	PASHAJ			V	V			V
HYSEN	PASHAJ			V				P

PELLUMB	PASHAJ			V					P
SOKOL	PASHAJ			X					P
RABIHAN	MERSINAJ			X	V		V	V	V
AVNI	MERSINAJ			X	X				V
PRANVERA	BARXHAJ			X					P
ANDROMAQI	LAPA			V	V		V	V	V
ANASTASIA	LAPA			V	X				V
LEANDRO	LAPA			V					P
ANDREA	LAPA			V					P
ISIDHORA	LAPA			V	X				P
ARTEMIS	KOCI			V			V	V	V
ELENI	PUKA			X					P
ELI	RRENIA			V	V				V
SPIRO	KALLAPODHI			X					P
MILEVA	ZIU					V	V	V	
PAVLINA	LITI			V	X				
XHILDA	LAKU			V	X				
PIERINA	PAPAJANI			V	X				
THEOLLOR	ZIU			V	X				
IBRAHIM	KUPI			V	X		V	V	V
XHEMILE	PECA			V	X		V	V	V
MEHMET	PECA			V	X				V
MUHARREM	PECA			V	X				V
SULBIJE	MEMA			V	X				V
HIRIE	RRAPI			V	X				V
NEXHMUIJE	JATA			V	X				V
BASHKIM	PECA			V	V				V
TEREZE	PERNUCA					V	V	V	
MARTE	PERDODA			V	X				X
DAVE	PALUCA			V	X				X
KRISTINA	PERNUCA			V	X				X
MARIANA	KUPE			X	X				X
GJET	GERA					V	V	V	V
PREND	GERA					V	V	V	ZV
		NDUE	GERA	V					P
		PAL	GERA	V	V				V
		FRROK	GERA	V					P
		MARTE	MARDEDAJ	V					P
		GJELA	MARKU	V					P
GJOK	GERA					V	V	ZV	
		MARIE	DUKA	V	V				
		MRIKE	DUKA	V	V				
		PJETER	GERA	V	V				
		PELLUMB	GERA	V	V				
		MARTIN	GERA	V	X				
		ARBEN	GERA	V	V				
		DAVITA	GERA	V	V				
BIB	GERA			X	X				
PRENG	GERA			V	X				
MARA	GERA					V	V	V	
KIMETE	TAFILAJ			V	V				X
ADMIR	TAFILAJ			V					X
LUAN	TAFILAJ			V					X
GENC	TAFILAJ			V					X
DHURATA	VEJUKA			V					X
MUHAMET	LANGU					V	V	V	
						X	V	V	
ZINET	TUFA	ARTAN	LANGU			V	X	V	
MYZEJEN	SHALA	SHPETIM	TUFA			V		V	
		SOKOL	SHALA	V					P
		ANOLA	XHULI	V	V				V
NAXHJIE	GASHI			V	X		V	V	
BEGE	BALLA			V	X				
SHKENDJIE	VEZI			V	X				
BIJAR	GASHI			V	X				
FATBARDHA	ÇUKA			V	X				
LEONARD	GASHI			V	X		V	V	V
GEZIM	SOPOTI			V	V		V	V	V
SHQIPE	SHYTI			V	X				V
FLAMUR	SOPOTI					V	V	V	V
		ALMA	DHAMO	V	X				
		MANJOLA	SOPOTI	V	X				
DILA	PALOKA					V	V	V	
GJOK	PALOKA			V	V		V	V	V
LEZE	NDJOJA			V	X				
MARIJE	KOLA			V	X				
DRANDE	GJONAJ			V	X				
FERDANE	MUCELLI			V			V	V	V
LIRI	MUCELLI			V			V	V	V
		XHAFERIE	SHEHU	X	X				X
		SABAJETE	MALKA	V					X
		DASHNOR	MUCELLI	V					X
		ENTELE	KALOTI	V					X
GRAMOZ	ZAIMAJ			V	V				ZV
SADO	KAMANI								
		FLORA	KOLLESHI	V					X
		RAMIZ	KAMANI	V					X
		SHAQ	XHAFERAJ	V					X
		VULLNET	KAMANI	V	X				
VERZIKO	GJATA					V	V	V	
		ATHINA	KAUSHLLAR	V					P
		NEVRESKE	HEMOLLAR	V					P
		MELEQ	GJATA	V	V				V
		TRENDELINI	AGOLLI	V					P
		NURE	DSMANLLAR	V					P
		GYHERE	JANOKLLAR	V					P
		IRINI	KODRA	V					P4
SEME	SKENDERI			V			V	V	V
NERENXE	KULA								
		HURMA	SHATO	V					P2
		NAZIKE	MILLOSHI	V					P2
		ERVHE	MILLOSHI	V	X				V2

Policia në Memaliaj sekuestron 50 kilogramë drogë, 1 në pranga, një tjetër në kërkim

Operacionet antidrogë, 7 veta në pranga

Kokaina nga Laçi shitej në Tiranë, kush janë të rinjtë e arrestuar

Policia në Memaliaj, në kuadër të operacionit "Amanikaj" ka sekuestruar 50 kg lëndë narkotike të llojit marijuanë, ndërsa ka vënë në pranga një 30-vjeçar si dhe një tjetër e ka shpallur në kërkim.

Sipas policisë, personi i arrestuar në flagrancë është shtetasi me iniciale B.K., 29 vjeç. Gjatë kontrollit në shtëpinë e të arrestuarit u gjet sasi e lëndës narkotike e dyshuar si marijuanë në formën e çokolatës. Shërbimet e Policisë kanë bërë të mundur kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasit B.K., 29 vjeç, si dhe shpallën në kërkim një shtetas tjetër. Nga kontrolli i ushtruar nga shërbimet e policisë, në banesën e shtetasit B.K. (në fshatin Zhapokikë) u gjetën 50 kg lëndë e dyshuar kanabis sativa në formën e çokolatës. Ky shtetas së bashku me shtetasin e shpallur në kërkim dyshohet se janë edhe autorët e tentativës për kultivim të bimëve narkotike në vendin e quajtur "Përoi i Madh" (zonë të pyllëzuar) në afërsi të fshatit Amanikaj, Memaliaj.



OPERACIONI NË TIRANË

Policia e Tiranës ka arrestuar gjashtë persona, të cilët shpërndanin lëndë narkotike të llojeve të forta dhe marijuanë. Në kuadër të operacionit policor i koduar "Stafeta", në pranga përfunduan pesë shtetas, të cilët dyshohet se sillnin kokainë nga qyteti i Laçit për ta shitur më pas në Tiranë. Ndërsa në aksionin e djeshëm policia arrestoi një tjetër shtetas, teksa iu gjet një sasi e vogël lëndë narkotike e llojit marijuanë. Në këtë aksion u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 249.2 gramë lëndë e dyshuar

narkotike e llojit kokainë, dy automjete dhe gjashtë telefona. **NJOFTIMI I POLICISË:** Tjetër goditje e shpërndarjes së drogave të forta në bashkëpunim. Finalizohet operacioni policor i koduar "Stafeta". Në pranga ranë pesë shtetas, që në bashkëpunim shisnin në kryeqytet në bazë klientele, lëndë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, të cilën e sillnin nga qyteti i Laçit. Sekuestrohet lëndë narkotike e llojit kokainë, automjete e aparate celular. Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në kuadër të operacionit policor të koduar



Droga e sekuestruar në operacionin "Amanikaj"

"Stafeta" arrestoi në flagrancë shtetasit:
- Gj. D., 36 vjeç, banues në Laç.
- M. P., 44 vjeç, banues në Mamurras.
- A. L., 25 vjeç, banues në Fushë-Kuqë/Patok.
- A. N., 23 vjeç, banues në Fushë Kuqë/Patok.
- E. D., 28 vjeçe, banuese në Laç.
Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë operative nga burime të ndryshme dyshonte se shtetasi Gj.D., me banim në Laç, në bashkëpunim me shtetasit M.P., A.L., A.N. dhe E.D. tregto-

nin dhe shisnin në kryeqytet me porosi klientele, lëndë narkotike të llojit kokainë, të cilën e sillnin nga qyteti i Laçit. Këta shtetas janë konstatuar nga shërbimet e policisë duke qarkulluar me dy automjete në rrugën e "Valiasit" në Kamëz dhe janë ndaluar për kontroll. Gjatë kontrollit të ushtruar, policia gjeti në njërin prej këtyre qese me lëndë të dyshuar narkotike e llojit kokainë. Janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 249.2 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, dy automjete dhe gjashtë aparate celular.



Gjykata e Tiranës liron protestuesit

Gjykata e Tiranës ka liruar 7 protestues, të cilët ishin ndaluar gjatë protestës së opozitës të shtunën.

Gjykata vendosi për këta persona masën e sigurisë "detyrim paraqitjeje". Protestuesit e liruar janë: Olsi Kasemi, Luis Bazheri, Maringlen Meçja, Gjok Dreshaj, Aleksandër Preqa, Agim Sallahu, Shefqet Sejfaq.



Makina del nga rruga, plagosen dy pasagjerë

Një aksident rrugor ka ndodhur dje në aksin Librazhd-Prrenjas, në fshatin Pishkash, ku drejtuesi i mjetit, Halil Petrela nga Tirana humbi kontrollin e makinës dhe për pasojë u plagosën dy pasagjerë. Fatmirësisht të plagosurit janë jashtë rrezikut për jetën dhe po marrin trajtim mjekësor në spitalin e Përrenjasit. Policia dhe grupi hetimor janë në vendngjarje dhe po punojnë për zbardhjen e shkaqeve. "Në aksin rrugor Librazhd-Prrenjas, në fshatin Pishkash, shtetasi H.P., duke drejtuar mjetin ka humbur kontrollin dhe ka dalë nga rruga. Për pasojë janë aksidentuar dy pasagjerë, të cilët ndodhen në spitalin e Përrenjasit, jashtë rrezikut për jetën", njofton policia.

Emrat, kush janë të dyshuarit për ngjarjen te Rruga e Barrikadave

Grabitja e pronarit të pikës së këmbimit valutë në Tiranë, 3 të tjerë në pranga

Policia e Tiranës arreston edhe tre persona të tjerë, bashkëpunëtorë në sulmin me qëllim grabitjen e pronarit të një "Exchange"-i, në Tiranë, shtetasit A. Sh. në Rrugën e Barrikadave, i cili ishte drejtuar bankës për të depozituar një çantë me para. Policia mundi të arrestonte pardje një prej autorëve, kurse një tjetër arriti të largohet bashkë me paratë. Kom-

misariati i policisë nr.1 ngriti një grup të posaçëm hetimor për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e vënien para përgjegjësisë ligjore edhe të personave të tjerë të përfshirë në vjedhjen me dhunë ndaj shtetasit A. Sh. Pas një pune intensive hetimore (krahas shtetasit Edvin Fata., 35 vjeç, të kapur dhe të arrestuar që në momentin e vjedhjes falë ndërhyrjes në kohë të patrullës së Policisë Rrugore) u arrestuan dhe tre bashkëpunëtorët e tjerë, shtetasit: Ervis

Berisha 37 vjeç, banues në Tiranë, i dënau më parë për "Vjedhje"; Blenard Hoxha, 27 vjeç, banues në Tiranë; Xhoni Dido, 23 vjeç, banues në Tiranë, i dënau më parë për "Vjedhje". Këta shtetas në bashkëpunim me njëritjetrin paraditen e djeshme në Rrugën e Barrikadave i kanë vjedhur me dhunë shtetasit A. Sh., një shumë lekësh. Nga veprimet procedurale të kryera në bashkëpunim me strukturat e komisariatit të policisë nr.3 dhe strukturat e tjera poli-



Policia në vendin e ngjarjes

core të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë rezultuan se këta shtetas janë dhe autorët të dyshuar të ngjarjes së ndodhur më 07 janar 2019, në rrugën "Mine Peza", ku dy persona të pidentifikuar i kanë vjedhur me dhunë çantën e shtetasit B. Sh., (roje pranë një pike këmbimi valu-

tor). Janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale edhe sendet e përdorura nga këta persona gjatë vjedhjeve: motor skuter, kokore, tub metalik, thikë dhe doreza plastike, doreza dhe veshje të përdorura nga autorët, tre aparate celular dhe automjet.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hytja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandit i III-të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazhi, Hytja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çirimin Sejfulla Xhalafa dhe Znj. Bardha Xhama me vlerë fillestare në ankand 20,454.84 (Njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë tëelëdhjetë e katër) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fish Daa", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, K1, 1, Tiranë
Web: www.3h-sh.com, Email: shqgj_3h@yahoo.com, cel:0692059711
Njofton shpalljen e ankandit nga dt.26.03.2019 deri ne dt. 04.04.2019 per: sendin e luajtshem mjeti me targë DR 9619 D ne pronesi te Hysni Gjergji
Cmimi fillestar eshte 560 EURO
Ankandit zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 04.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Shoqëria përmbarimore JUSTITIA
për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vlerë fillestare: NRG BANK/AGRI BANK, me kosto të dhurës: Nr. 1387-NI, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 91 e llojit njesi me sip. 109 m² ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babam", Korçë ne pronesi te Pandeli Bonja.
Cmimi me te cilin fillon ankandit eshte ne vleren 48.832 EUR(dyzete e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) EUR
Nr. 1587-N3, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 93 e llojit njesi me sip. 89.2 m² ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babam", Korçë ne pronesi te Pandeli Bonja.
Cmimi me te cilin fillon ankandit eshte ne vleren 39.961 EUR(tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) EUR.
Ankandit zhvillohet ne datën 29.04.19, ne portulmid te orarit zyrtar, ora 16:30 ne zyren e permbarimit gjyqësor, me Adrese: Bulevardi "Bajram Curri", Palli 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojshilla.com, tel. +355 4 2270890

EKSPOZITA

Dalin dorëshkrimet e Santorit, si iu fshi firma e Fishtës pas sekuestrimit


Fatmira Nikolli

Rilindasi, prifti dhe poeti arbëresh Francesk Anton Santori u përkujtua dje në Shkodër, përmes ekspozitës së organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Biblioteka Françeskane, Fondacioni "Francesco Solano" dhe Universiteti i Shkodrës. Një ekspozitë u çel për të me rastin e 200-vjetorit të lindjes. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave prezantoi ekspozitën me dorëshkrimet e At Santorit, që shfaq rolin e tij në fushën letrare dhe fetare.

I pranishëm në ekspozitë, studiuesi arbëresh Mateo Mandala tha se përkthimet e tij të lutjeve recitohen ende sipas përkthimit të tij në disa fshatra arbëreshë. Historia e udhëtimit të këtyre shënimeve në Shqipëri është e veçantë. 65 fletë me përralla, përkthime, studime, lutje dhe fjalë iu dhuruan At Gjergj Fishtës në Amerikë më 1922 nga arbëreshët. Prej andej, Fishta i sollë në Shkodër dhe i mbajti në Kuvendin Françeskan deri kur vdiq. Pas vdekjes së tij, me instalimin e regjimit komunist, dorëshkrimet e Kuvendit u sekuestruan dhe gjithë ç'kishte u dërgua në Arkivin Qendror të Shtetit. Aty, siç del sot, shënimi "Dhuruar At Gjergj Fishtës" u shkarravit dhe mbetën pa siglimin që tregonte udhëtimin e tyre.

Pothuaj 30 vite pas rënies së regjimit është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, që i shfaq sërish. Një pjesë të dorëshkrimeve të tjera të Santorit janë në Danimarkë dhe një pjesë në Kalabri - tha studiuesi arbëresh, Mateo Mandala. Po dje në Shkodër u mbajt edhe një konferencë shkencore për Santorin. Në mbarim të sesionit shkencor pati një shfaqje teatrale santorjane nga studentët e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe këngë popullore të korit arbëresh "I Paradosis"-G.B.Rennis". Teatri "Illyricum" Gjuhadol (te Kisha Françeskane) vuri në skenë disa pjesë të dramës së Santorit "EMIRA", të shoqëruara me këngë popullore të nxjerra nga veprat santorjane (grupi "Shpirti Arbëresh" i Qanës dhe grupi i Picilisë.

Francesk Anton Santori




Studiuesi arbëresh dhe historia e udhëtimit të letrave nga Amerika



Francesk Anton Santori (1819-1894) ishte poet e dramaturg arbëresh. Ishte nga Shën Katerina e Kozencës. Studioi teologji dhe pjesën më të madhe të jetës e kaloi në manastir, prej nga u largua vitet e fundit.

tos, Komunës së Santa Caterina Albanese, Arqipeshkëvisë Shkodër dhe Urdhrit Françeskan. Ekspozita do të qëndrojë e hapur një javë, në Librarinë Françeskane "Gjergj Fishta" të qytetit të Shkodrës, pranë Pedonales. Sot paradite do të mbahet një meshë solemne në përkujtim dhe nder të 200- vjetorit të lindjes së françeskanit dhe famullitarit arbëresh F.A.Santorit e udhëhequr nga Arqipeshkëvi i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra, me pjesëmarrjen e priftit arbëresh, Dom Ennio Stamile, i deleguar nga Ipeshkëvi i Dioqezës së Shën Markut Arxhentan. Gjatë celebrimit të Meshës së shenjtë do të recitohen lutje dhe do të këndohen këngë arbëreshe të përkthyer arbërisht nga vetë Patër Santori.

E DIEL
31 Mars
2019



Për Endri Kekon dhe ata që iu dedikuan dokumentarit shqiptar


In Memoriam

Endri Keko, një nga themeluesit e kinematografisë shqiptare, sot do të ishte 95 vjeç (1924 - 1989). I mirënjohur nga publiku kryesisht si regjisor i filmit dokumentar, për afro 30 vjet ai fiksoi në ekran... jetën e shqiptarëve në të katër anët e vendit, njerëzit që me shembullin e tyre udhëhiqnin rindërtimin dhe më pas ndërtimin e vendit, intelektualët e spikatur që i bënë nder vendit, ngjarjet madhore të Shqipërisë... Me krijimtarinë e tij, në harkun kohor të viteve 1952 - 1979 regjisor i Endri Keko ishte padyshim firma e parë e filmit dokumentar shqiptar, personaliteti më i spikatur i kësaj gjinie dhe më i vlerësuar.



140 - vjetori i lindjes së Aleksandër Moisi

A mbetet Moisiu, aktori më i madh i botës gjermanike?!



NGA ISHTE AI DHE SI U BË AI

Si mund të bëhej e mundur që një njeri, i cili i përkiste një race të huaj, një gjuhe të huaj, në teatrin gjerman - dhe përtej tij - ka arritur kulmin në art.

Aleksandër Moisiu lindi në Trieste. Babai i tij Kostandini ishte shqiptar nga qyteti i portit të Durrësit. E ëma italiane, gjuha e nënës italishtja. Kur ishte gjashtë vjeç ai shkoi në Durrës, në vendlindjen e të atit, atje ndoqi shkollën e parë. Në fillim shkrimin dhe këndimin i mësoi në gjuhën greke dhe shqiptare. Në Durrës nuk kishte gjuhë të tjera mësimi. Kur ishte dhjetë vjeç ai u kthye në Trieste, atje i vazhdoi studimet në shkollat italiane. Tetëmbëdhjetë vjeç ai shkoi në Vjenë, pa e zotëruar aspak gjuhën gjermane, i'a doli mbanë me vështirësi me mësim gjuhe italiane. Dëshira e tij ishte që ta ushtronte zërin e bukur për këngë në konservatorin e Vjenës, por për këtë nuk i mjaftonin paratë.

Një rastësi e çoi atë në Teatrin Kombëtar Austriak si statist. Atje pas një kohe të shkurtër i bëri përshlyetje Jozef Kaicit, edhe Paul Shlenteri, drejtori i atëhershëm i Teatrit Kombëtar Austriak, i kushtoi vëmendje statistik të ri. Të dy këta burra të shkëlqyeshëm të teatrit i treguan Moisiut talentin e tij aktorial, dhe kjo mjaftoi që brenda tij të ndizej entuziazmi më i madh për profesionin e aktorit.

Zelli, vullneti i hekurt, dëgjimi i jashtëzakonshëm i'a bënë kaq të afërt gjuhën gjermane as për tre muaj, sa që ai tashmë pas një mundësie kërkoi që të dilte përpara publikut. Ai interpretoi përpara drejtorit të teatrit të Pragës, Anxhelo Nojmanit, dhe u angazhua menjëherë. Drejtori i tij i besoi sakaq rolet më të mëdha. Besimi i Anxhelo Nojmanit te mundësitë e Moisiut ishte i pakufishëm: Roli prezantues i Eliasit (Björnson, "Mbi forcën tonë", pjesa e parë dhe e dytë), pastaj Franc Mor, Mortimer, Carlos in Clavigo, madje Cyrano de Bergerac.

Pas një viti e gjysëm atij Praga i'u duk shumë e ngushtë, shumë provinciale, me shumë pak ngjyra. Për fat të mirë ai udhëtoi drejt Berlinit. Nuk kishin kaluar as dy orë në kryeqytetin gjerman të Rajhut dhe tashmë ai qëndron - sërish rastësi - përpara Maks Rajnhardit. Njeriu njomëzak, krejt i dobët, i pahijshëm reciton, dhe Rajnhardi është kaq i entuziazmuar dhe i tronditur, sa kurrë ndonjëherë më parë.

Në këtë numër: ENDRI KEKO, HIKMET FERIDUN ES DHE KUJTIM NURO PËR SAMI FRASHËRIN, TË MËDHENJTË PËR ALEKSANDËR MOISIUN, INIS JORGO, ENTON PANARITI...

P

PERSONAZH

Në kuadër të 95-vjetorit të lindjes së dokumentaristit të shquar, "Milosao" po i dedikon një përmbledhje. Endri Keko ka punuar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore dhe është i pari dokumentarist, i shpërfaqur në të gjitha zhanret e saj, që solli frymën e Shqipërisë së pasluftës, një vendi krejt gërmadhë dhe me shumë shpresa...

Për Endri Kekon dhe ata që iu dedikuan dokumentarit shqiptar

NGA BEN ANDONI

Për ata që duan të gjejnë probleme me këtë figurë e kanë të lehtë. Endri Keko ka punuar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore dhe është i pari dokumentarist, i shpërfaqur në të gjitha zhanret e saj, që solli frymën e Shqipërisë së pas luftës, një vendi krejt gërmadhë dhe me shumë shpresa. Ndonëse shumë nuk e kuptojnë ose bëjnë sikur nuk e kuptojnë, Shqipëria e viteve '50 ishte e mbushur me një frymë optimizmi dhe paqe mirëfilli, që buronte nga paqësia e një sistemi ekonomiko-shoqëror shumë "idealiste". Po mbylleshin plagët e luftës dhe njerëzit po mësoheshin me këtë sistem që të mbushte asokohe me frymë paqe dhe ngadhënjimi. Mbështetja te Bashkimi Sovjetik dhe garancia e kësaj lidhje e bënte më të paqë gjithçka, kurse vendi dalëngadalë po binte nën letargjinë nanuritëse të propagandës së re. Ashtu si çdo regjim mundohet të përshfaqë fillimisht imazhin e vet, edhe sistemi socialist po vinte mes njerëzve me anë të frymës së një paqësie dhe pune, por edhe optimizmi të pafre, ku shqiptarët për herë të parë e shikonin njëri-tjetrin si të barabartë.

Endri Keko, ashtu si pak kolegët e tij pionerë në këtë fushë arti, nuk mund të bënin desidentët në një terren që ende nuk e njihnin, por duhet të afirmimin besimin që vendi i tyre u kishte dhënë duke i shkolluar në shkollat më të mira të filmit të asaj kohe, tekta duhej të kapnin shpirtin e popullit të tyre, mbushur plot ngazëllim. Por siç ndodhte, specialistëve si Endri Keko u duhej t'i bënin vetë të gjitha në fushat e prodhimit sepse grupet e bashkëpunëtorëve që u përgjigjeshin jo thjesht ishin larg nivelit të tyre, por duhet të mbushnin diferencën kulturore dhe profesionale të mëdha, që vinin nga formimit dhe mungesat e honëta.

Ndaj, këtu duhet të besohet ditari dhe fryma që sjell Endri Keko. Ai është si të gjithë i mrekulluar me Enver Hoxhën ndërsa inkurajimi që i bëhet për punën duhet ta justifikojë sa më mirë. Keko jo thjesht do ta tregojë por më shumë se çdo gjë tjetër do t'i japë fizionominë e vet dhe madje do të jetë novator, paqka se sot shumë kine bëjnë sikur do të ishin të aftë t'ia plasnin hapur regjimit.

Përcjellja e idesë, dokumentimi i frymës së kohës, gërshetimi i tablove dhe mënyra e vendosjes së kamerave janë nga gjërat më të arrira që bëjnë autor. Edhe njëherë tjetër: është herët të bëjë



desidentin, siç pretendojnë shumë, por na jep dokumentimin e saj kohe, në frymën e një dokumentaristi shumë profesionist me një

material autentik që do t'i shërbejë studiuesve, historianëve, antropologëve, studiuesve të ndryshëm dhe politikanëve, por pa lënë

Për dokumentarin e Kekos

Përcjellja e idesë, dokumentimi i frymës së kohës, gërshetimi i tablove dhe mënyra e vendosjes së kamerave janë nga gjërat më të arrira që bëjnë autor. Edhe njëherë tjetër: është herët të bëjë desidentin, siç pretendojnë shumë kolegë të tij më të rinj sot, por na jep dokumentimin e saj kohe, në frymën e një dokumentaristi shumë profesionist me një material autentik, i cili do t'u shërbejë studiuesve, historianëve, antropologëve, studiuesve të ndryshëm dhe politikanëve, por pa lënë pas dhe kolegët e sotëm të dokumentarit...

pas dhe kolegët e sotëm të dokumentarit.

Endri Keko shkollon kudo. Kap me kujdes rrethanat që përcaktojnë ngritjen e individit shqiptar dhe jep mënyrën sesi përcillet lidhja e madhe e ideologjisë me angazhimin e njerëzve. Duke njohur mirë punën nën presione ideologjike, dekada më vonë, kur ai nuk do të jetë më gjallë, kolegë më të rinj dhe realistë profesionistë jo vetëm e justifikojnë por e

nderojnë duke treguar dhe një respekt për artin shqiptar të dokumentarit.

Vetë Endri Keko nuk mund të ndihet më në këtë kohë, ku propaganda ka marrë kah tjetër; por pas la kujtimin e një artisti të madh dhe të respektuar, e mbi të gjitha shembullin e një njeriu, që paqka çfarë fryme përcolli (i diktuar prej kohës dhe rrethanave), tregoi se arti e gjen shtegun e vet, paqka përmbajtjes së diktuar.

NË PËRVJETORIN E NJË KINEASTI TË SHQUAR SHQIPTAR

Endri Keko, një nga themeluesit e kinematografisë shqiptare, sot do të ishte 95 vjeç (1924 - 1989). I mirënjohur nga publiku kryesisht si regjisor i filmit dokumentar, për afro 30 vjet ai fiksoi në ekran... jetën e shqiptarëve në të katër anët e vendit, njerëzit që me shembullin e tyre udhëhiqnin rindërtimin dhe më pas ndërtime të vendit, intelektualët e spikatur që i bënin nder vendit, ngjarjet madhore të Shqipërisë... Me krijimtari të tij, në harkun kohor të viteve 1952 - 1979 regjisor i Endri Keko ishte padyshim firma e parë e filmit dokumentar shqiptar, personaliteti më i spikatur i kësaj gjinie dhe më i vlerësuar. Fitues i Kupës për filmin më të mirë dokumentar në Festivalin e dytë të Filmit Shqiptar (1977) dhe Festivalin e tretë të Filmit Shqiptar (1979), fitues i Çmimit të Nderit në Festivalin e Karlovivarit (Çekosllovakia - 1952), Diplomës së Nderit në Festivalin e Moskës (BRSS - 1959), Medaljes së Bronzit në Festivalin e Parisit (Francë - 1962) dhe Diplomës së Nderit në Festivalin e Laipcigut (DDR - 1962), fitues i tre Çmimeve të Republikës në vitet 1959, 1970 dhe 1979, fitues i shumë çmimeve në konkurset letrare për skenarë filmash, Endri Keko, Artist i Popullit, vazhdon të konsiderohet edhe sot, një nga personalitetet më të spikatura të kinematografisë shqiptare. Filmata dokumentarë "Shqipëria", "Dritë mbi Shqipëri", "Pranvera e nëntë", "Në shtigjet malore", "Letër nga fshati", "Ringjallje", "Vallzim i shqipeve", "Në flakë të revolucionit", "Rruga jote, shok", "Tregim në sytë e nënës", janë vetëm disa nga titujt e realizimeve që mbajnë firmën e regjisorit që lëvroi me sukses të gjitha zhanret e saj, që nga filmi kronikal, kinoreportazhi e kinopoeama deri tek filmi dokumentar e ai artistik.

Me të njëjtin përkushtim e me të njëjten dashuri, Endri Keko e hodhi jetën dhe aktivitetin e tij artistik, edhe në letër. Janë mijëra faqe me shënime në arkivin e tij personal që e dëshmojnë këtë jetë intensive dhe këtë punë pasionante e që ai në gjallje punoi për ta sistemuar e botuar. Një pjesë i botoi në shtypin e kohës, por pjesa më e madhe ende nuk e ka parë dritën e botimit. Deri atëherë, ne po sjellim për lexuesit nga ditari në dorëshkrim disa momente nga meditari i regjisorit Endri Keko në përvjetorët e kinematografisë shqiptare.



K

KINEMATOGRAFIA

KRISTAQ DHAMO - REGJISOR

Endri Keko është autor i të parit film kronikal dhe regjisor i të parit film tematik. Edhe pse parapëlqente temën politiko - shoqërore, ai ka hyrë dhe ka mbetur në historinë e kinematografisë sonë si një dokumentarist i gjithanshëm dhe nismëtar thuajse i të gjitha zhanreve të filmit dokumentar: kinoreportazhi, kinoportretit, filmit pamflet, biografik, muzikor, historik, kinopoemës dhe dokumentarit me subjekt.

VIKTOR GJIKJA - REGJISOR

Ai ka ditur të pasqyrojë drejt në kinematografinë tonë dokumentare momentet e kthesave të mëdha në psikologjinë dhe mentalitetin e njerëzve të lidhur ngushtë me kushtet historiko - shoqërore, ndaj me të drejtë thuhet: Filmat e regjisorit Endri Keko kanë vullën e kohës.

DRITËRO AGOLLI - SHKRIMTAR

Endri Keko e donte si jetën kinematografinë dhe gëzohej si fëmijë për ecjen e saj, se vetë ishte nga pionierët e parë të lindjes së këtij arti të ri në vendin tonë. Ai ishte i pari që krijoi kronikën kinematografike dhe filmin dokumentar. Po t'i shohësh sot filmat e regjisorit Endri Keko, do të ndjesh atmosferën e viteve kur janë xhiruar, por do të vesh re edhe ndjenjën e hollë të perspektivës, që kishte ai për vendin dhe njerëzit. Ashtu siç do të konkludosh se, filmat e tij ishin sintezë e përgjithësues, pasi ngjarjet dhe faktet e vërteta të jetës ai i ngrinte, i arsyetonte dhe i jepte përmes filmit në lëvizje, dhe do të kuptosh se, Endri ishte dhe një parashikues realist e në të një-

Regjisor i parë i ekranit shqiptar, kinodokumentaristi Endri Keko (Artist i Popullit), e nisi punën si regjisor qysh në fillim të viteve '50, kur ende ishte student në Moskë. Më 1952, ditën e inaugurimit të Kinostudios "Shqipëria e Re", duke firmosur në kinozhurnalin e parë si regjisor i tij, një realizim dhe prodhim ky tërësisht shqiptar, ai firmosi edhe rrugëtimin e gjatë në ekran. Vepra e tij për gati tri dekada që shquhet për nivelin e lartë artistik, i bënë ndër edhe sot kinemasë shqiptare, ndërkohë që emri i tij mbetet ndër më të spikaturit e atyre njerëzve, të cilët me përkushtim i shërbyen shoqërisë dhe ndër më të respektuarit, pasi dhjetra kineastë të rinj kanë patur si udhërrëfyes në krijimtarinë e tyre mjeshtrinë e shkollës së regjisorit Endri Keko.

Në 95-vjetorin e lindjes së kinoregjisoris Endri Keko

matografinë dhe gëzohej si fëmijë për ecjen e saj, se vetë ishte nga pionierët e parë të lindjes së këtij arti të ri në vendin tonë. Ai ishte i pari që krijoi kronikën kinematografike dhe filmin dokumentar. Po t'i shohësh sot filmat e regjisorit Endri Keko, do të ndjesh atmosferën e viteve kur janë xhiruar, por do të vesh re edhe ndjenjën e hollë të perspektivës, që kishte ai për vendin dhe njerëzit. Ashtu siç do të konkludosh se, filmat e tij ishin sintezë e përgjithësues, pasi ngjarjet dhe faktet e vërteta të jetës ai i ngrinte, i arsyetonte dhe i jepte përmes filmit në lëvizje, dhe do të kuptosh se, Endri ishte dhe një parashikues realist e në të një-

jtën kohë romantik, një njeri dhe artist që dinte të ëndërronte, që e donte dhe e çmonte të bukurën.
MEVLAN SHANAJ - REGJISOR
 Çmoj me bindje se një emër si Endri Keko, nderon padyshim kulturën tonë të ekranit, e cila ka vendosur themelet e profesionalizmit dhe pasurisë sonë kombëtare, në gjithë mendjet dhe zemrat e brezave që me mund e sakrificë, nuk rreshtën së dhëni më të mirën në transformimin e vendit. Endri Keko ka meritën e krijimit të dokumentarit jo vetëm pasqyruar, por edhe atij artistik. Janë të paharruara për publikun por dhe shumë të çmuara për stu-

diuesit e kinemasë shqiptare kuadrot e dokumentarëve të tij, kuadro që kanë sjellë natyrën, ngjarjet, jetën dhe njeriun shqiptar të atyre viteve me një vërtetësi të rrallë.
LLAZAR SILIQUI - POET
 Realizmi dhe poetika në filmat e regjisorit Endri Keko ndërthuren aq bukur sa jo vetëm të befasojnë, por edhe të frymëzojnë.
KIÇO BLUSHI - SHKRIMTAR
 Regjisorin Endri Keko në krijimtarinë e tij më të mirë e dallon gjuha e gjallë dhe krahasuese, shprehëse dhe poetike, kuadri i pastër dhe komunikimi me spektatorin.

SOFOKLI AFEZOLLI - GAZETAR

Endri Keko padyshim ka preferuar temën politiko - shoqërore në kinematografi. Por, atë e njohim si një dokumentalist të gjithanshëm. Ai është po aq politik sa dhe mjeshtrë sensibil në filmin "Valzimi i shqipeve", sa krijues me nota të holla romantike në filmin "Ringjallje" aq dhe pamfletist i mprehtë në filmin "Në flakë të revolucionit".

KUJTIM GJONAJ - REGJISOR

Endri Keko është një ndër regjisorët më të shquar të Kinostudios, është pionieri i parë i saj dhe është mësuesi i dhjetra e dhjetra kineastëve.

NË RRUGËTIMIN E KINEMATOGRAFI SË SHQIPTARE

NGA ENDRI KEKO

E Enjte, 10 Korrik 1952

Dola nga shtëpia pa lindur mirë dielli dhe mora rrugën për në Kinostudio.

Mëngjesi ishte me qiell të pastër dhe i freskët.

Anëmbanë, në shtylla telefoni dhe elektriku, në ballkone e në dritare, ishin varur flamuj e parrulla. Përkujtohet dita e krijimit të Ushtrisë sonë Popullore.

Gjatë rrugës, takova dhe shumë nga ata që sot e tutje do të përbëjnë kolektivin e Kinostudios. Më duket si çudi që po e fillojmë punën me kaq pak njerëz, një pjesë e mirë fare të rinj, pesëmbëdhjetë - gjashtëmbëdhjetë vjeçarë. Shumica nuk e kanë idenë e punës në kinematografi, por, tek të gjithë ndihet entuziazmi për punën që na pret në të ardhmen.

Kur hymë në Kinostudio ora po shkonte gjashtë. Çdo gjë shkëlqente. Më bukur as që mund ta imagjinoja. Edhe zgjitë sikur këndonin ndryshe. Një ndjenjë e thellë kënaqësie më pushtoi.

Jashtë, në oborr, vazhdonin punën teknikët e Kinostudios dhe të Radio - Tiranës për vendosjen e mikrofonave dhe altoparlantëve. Dolën aty edhe kinooperatorët me aparatet e xhirimit dhe bashkë me ta fotografi i ATSH.

Në orën nëntë rruga përpara Kinostudios ishte mbushur plot me njerëz që kishin ardhur nga qyteti më këmbë apo me biçikleta, karroca, kamionë, pajtonë. Kishte aty nëpunës e ushtarakë, punëtorë, nëna dëshmorësh, invalidë të luftës, nxënës, artistë, shkrimtarë.

Ndërkohë, fshatarët që kishin ardhur nga ana e Dajtit lëviznin ngadalë përbi kangjellave të oborrit të Kinostudios dhe prej andej përpqishin të shikonin sa më mirë ato që i tërhiqnin më shumë

në vështrimin e parë, statujat mbi hyrjen kryesore.


A kishte kënaqësi më të madhe për grupin e skulptorëve dhe piktorëve tanë që punuan këtu për muaj të tërë... Odise Paskalin, Jan-raq Paçon, Vangjush Mihon, Abdurrahim Buzën, Llazar Nikollën, Andrea Manon, Nexhmedin Zajmin, Sadik Kacelin, Enver Top-tanin, Qamil Grezdën?

Kur ora po afronte dhjetë dhe oborri i Kinostudios ishte mbushur plot, dikush porositi që të pakësoheshin lëvizjet e tepërta. Kjo u desh. Anëmbanë u hap lajmi se në inaugurimin e Kinostudios do të vinte vetë Enver Hoxha.

Të mëdhenj e të vegjël filluan të shtyhen, të ngjeshen, të ndërrojnë vendet, të dalin përpara. Eshhtë dëshira e të gjithëve për ta parë sa më afër udhëheqësin.

Shkova tek operatorët. Jani Nano me Mehmet Kallifën morën aparatit me gjithë stativ dhe e vendosën pranë hyrjes kryesore. Kjo lëvizje e bërë me shpejtësi hoqi nga njerëzit edhe atë pak dyshim që mund të kishte mbetur për ardhjen e Enver Hoxhës. Filluan këngët, parrullat, duartrokitjet. Dita e filmit të festojnë si një nga ngjarjet më të mëdha të Shqipërisë.

Në orën dhjetë, dikush thirri "erdhi!" Si të gjithë, edhe unë ktheva kokën andë nga pritej të vinte Udhëheqësi. Pa kaluar disa sekonda, tek hyrja kryesore pashtë të zbrishte nga vetura Enver Hoxha i veshur me kostum të bardhë. Pas tij, Kryetari i Presidiumit të Kuv-



endit Popullor Omer Nishani, antarët e Byrosë Politike Hysni Kapo, Gogo Nushi, Beqir Balluku e Spiro Koleka dhe nënkryeminstri Bedri Spahiu.

Oborri oshëti nga ovacionet e pandërprera.

Eshhtë e para herë që ndodhem kaq pranë tij, dhe, me siguri, po të më kishte pyetur si e ke emrin, nuk do t'i isha përgjigjur dot.

I qeshte fytyra, i qeshnin sytë. Ai ecte dhe përshëndeste. Shikoja rreth e rrotull se si njerëzit s'përmbaheshin dot nga gëzimi dhe më vinte inat që këtë tablo të mrekullueshme ne nuk ishim në

gjendje ta xhironim në film me atë bukuri dhe ato emocione që krijohehin nga çasti në çast. Dy aparatet tona marrës, ashtu si ishin, të mbërthyer në stativa, mund të fiksonin në film shumë gjëra, por ata nuk mund të fiksonin kurrsesi ato që flisnin këtu më shumë se çdo gjë tjetër: detajet. Humbën përgafimet e ngrohta, buzëqeshjet e njerëzve, shtrëngimet e duarve, sytë e gëzuar. Këtë e kuptoj unë, këtë e kuptojnë edhe kinooperatorët të cilët sot për sot nuk mund të bëjnë më shumë sepse të gjithë ne akoma nuk dimë t'i kapim shpejt gjërat më të do-

mosdoshme dhe më domethënëse, ende nuk jemi në gjendje t'i përdorim siç duhet në këto lloj xhirimesh aparatet marrës. Kjo gjëndje, sidomos mospërdorimi me shkathtësi dhe siguri profesionale i aparateve, është minus i madh për ne, sepse kjo zbeh në ekran atmosferën e ngjarjeve.

Me shqetësimin për të dokumentuar sa më mirë gjithshka po ndodhte, xhiruan mitingun ku përshëndetën kryetari i Komitetit të Arteve dhe Kulturës Fatmir Gjata, nënkryeminstri Bedri Spahiu, një specialist sovjetik e një specialist shqiptar dhe shkuan vendosëm aparatet përpara hyrjes kryesore të Kinostudios ku do të bëhej prejra e shiritit.

Pas disa çastesh shpërthyen duartrokitjet dhe drejt shiritit të kuq u afrua Enver Hoxha. Ai zgjati dorën dhe pasi mori gërshtërit nga tabakaja që mbante në duar Xhanfise Çipi, shoqja dhe kolegia ime, preu shiritin duke uruar të gjithë të pranishmit "Ta gëzoni Kinostudion!".

Ai kapërcë derën kryesore, dhe, ndërsa ecim nëpër korridor... Në një moment u paraqit nevoja të afrohem pranë tij. Më dha dorën dhe buzëqeshi. Shpëtova, thashë me vete.

-Puna e parë që ju duhet të bëni, dhe, m'u drejtua - është të mësoni të jeni të thjeshtë dhe të mbani kurdoherë lidhje të ngushta me popullin, pasi vetëm kështu do të mund

Vijon nga faqja 15

ta njihni mirë jetën e tij, hallet, gëzimet dhe përpjekjet e mëdha. Ju jeni në hapat e para të punës, prandaj ato hidhni që në fillim mirë.

Me këto fjalë që të bënin me krahe, mbërritëm në repartin e zërit. Ishte vendi ku ne do të shfaqnim kinoshkollurin Nr.1, film-in tonë të parë shqiptar, ideuar, xhiruar, montuar, inçizuar dhe përpunuar, tërësisht me forcat dhe mjetet tona.

Zemra filloi të më rrahë me të madhe. Shoh shokët: Hamdiun, Sokratin, Janin, Xhanfisenë, Koçon, Petraqin, Mishën... Të gjithë janë po aq të shqetësuar sa dhe unë.

Në sallë u vendos qetësia. Nga pulsi u dëgjua zëri i Koços: Gati!

Lavdiu fiku dritat dhe shkeli butonin e aparatit të projeksonit.

U mbështeta në karrige dhe i mbërtheva sytë në ekran. Çdo gjë po shkonte shumë mirë. Shumë mirë projeksoni, shumë mirë zëri, shumë mirë reagimi. Kur në ekran dolën punëtorët të lidhur me litar në Shkëmbin e Shkopitit, Enver Hoxha duartrokoi. Duartrokiti edhe kur u nis karvani me grurë nga fshatrat e Lezhës për në depot e shtetit.

Ne nuk jemi ende artistë, ne nuk i kemi provuar ende emocionet krijuese, por në këtë moment, ajo duartrokitje për ne vlen shumë.

Pas dymbëdhjetë minutash dritat u ndezën dhe në sallë shpërthyen duartrokitjet. Kishte mbaruar projektimi i kinoshkollurin Nr. 1, i të parit film të Kinostudios "Shqipëria e re".

Enver Hoxha u ngrit në këmbë dhe për disa sekonda nuk foli. Duket priste të afroheshin më afër se kushdo, ata që kishin punuar për realizimin e kinoshkollurin.

Kinoshkollurini ishte i bukur, kishte jetë, gjallëri. Mbi të gjitha, ai është një fillim shumë i mirë dhe i mbarë. Urime! - tha pastaj duke na parë e buzëqeshur të gjithëve.

Pak çaste më vonë, tek dera kryesore, kur po ndaheshim, Nesti Zoto, drejtori i Kinostudios, i dhuroi Enver Hoxhës kopjen e kinoshkollurin Nr.1 të cilin ai e mori me një kënaqësi që i lexohej lehtësisht në fytyrë.

- Edhe një herë urime dhe punë të mbarë, - tha. Ai dhe na shtrëngoi dorën me radhë, të gjithëve.

Ora kishte shkuar dymbëdhjetë. Dielli shkëlqente në kupën e qiellit dhe Kinostudioja, e bardhë si bora dhe e rrethuar prej trëndafilash të kuq, qëndronte si nusja në bash të odës.

Lum kush e ka e lum kush do ta gëzojë!

E Martë, 10 Korrik 1962

Sot, në dhjetëvjetorin e kinematografisë shqiptare duke medituuar mbi punën e derisotme, timen dhe kolegëve të mi, mendova të hedh në letër disa mendime lidhur me problemet që ekzistojnë në shkrimin e skenarëve dhe mundësitë e bashkëpunimit me të ngushtë mes shkrimtarëve dhe kineastëve, pasi ato janë vendimtare për ecurinë e filmit dokumentar.

Kinematografia jonë dokumentare gjatë këtyre viteve të ekzistencës së saj i ka pasqyruar përgjithësisht mirë të shkuarën dhe të sotmen e Shqipërisë, bashkë me të dhe të njeriut shqiptar.

Autorët realizues të këtyre filmave dokumentarë, në jo pak raste kanë arritur të tregojnë me emocion në ekran injorancën, prapambetjen, varfërinë dhe mjerimin në të cilën kanë jetuar e punuar shqiptarët në të kaluarën. Dhe e kanë bërë këtë pa droje pasi kanë qenë të bindur se njerëzit duan të shohin në ekran të vërtetën e jetës së tyre.

Autorët realizues të këtyre fil-



NË RRUGËTIMIN E KINEMATOGRAFISË SHQIPTARE

mave dokumentarë, në jo pak raste kanë arritur të tregojnë me emocion në ekran njerëzit tanë duke u përleshur me shkëmbin për ngritjen e digës së hidrocentralit, duke luftuar mes flakëve të zjarrit për të shpëtuar pusët e naftës, duke punuar mes lumenjve për të ngritur urat e trenave, duke hapur taraca nëpër shpatet e maleve, duke ngritur shtyllat e tensionit të lartë majë maleve të thepisur, duke lartësuar ohaqet e uzinave dhe fabrikave. Dhe e kanë bërë këtë pasi kanë qenë të bindur se bukuria e jetës sonë qëndron në përpjekjet dhe forcen e njerëzve për t'i kapërcyer vështirësitë.

E para, përcaktimi i saktë i temës. Vetëm pas kësaj dhe përcaktimit po kaq saktë të pikënisjes, pikëmbërjes dhe qëllimit, mund të shprehjojmë të realizojmë një film dokumentar të suksesshëm.

E dyta, seleksionimi i materialit. Është tërësisht në dorën tonë të përzgjedhim dhe evidentojmë më tipikën e më të veçantën nga moria e ngjarjeve dhe fakteve dhe të mos e lemë në mëshirë të fatit suksesin e filmit të ardhshëm.

E treta, njohja me materialin arkivor ekzistues. Ai na ndihmon më shumë se çdo gjë tjetër në rikrijimin e atmosferës së kohës, por, me pak fat dhe meqenë, mund të na shërbejë edhe në krijimin e episodeve të fuqishëm e me vlerë.

E katërta, këndvështrimi i ri. Kërkimi dhe gjetja e pikave të reja të të shkuarit të temës, apo, kërkimi dhe gjetja e pikave të pa konsumuara deri atë çast nga syri i spektatorit, është një moment



veshjes artistike skenarit të filmit dokumentar. Vetëm se, veshja artistike në skenarin e filmit dokumentar duhet të mos çënojë realitetin apo të mos shkojë përtej realitetit.

Referuar bindjes sime se, baza e kinematografisë dokumentare është dhe mbetet realizimi i të pasqyruarit në ekran i jetës dhe njerëzve, konstatohet më kënaqësi se pjesa më e madhe e filmave tanë të realizuar deri më sot, shquhen për realizimin e tyre të thellë. Kjo edhe për meritë të skenaristëve të cilët kanë ditur e mundur të ndërtojnë skenarë realistë.

Për të ilustruar sa thashë më lart, po jap vetëm dy shembuj. Autori i skenarit të filmit dokumentar "Dritë mbi Shqipëri", poeti Llazar Siliqi, për t'i mbetur besnik asaj që ndodhte në mjedisin e ndërimit të hidrocentralit, ndërtoi episode dhe gjeti mjete shprehëse artistike të cilat gjatë xhirimit e plotësuan atë më së miri dhe bënë që gjithshka jo vetëm të ishte e besueshme, por dhe emocionuese. Po kështu, autori i skenarit të filmit dokumentar "Migjeni", kritiku Andon Kuçali, nuk rendi pas ndonjë aktori që të rikrijonte portretin e poetit apo pas rrugicave të Shkodrës që të rikrijonte kohën kur jetoi e krijoi Migjeni. Jo. Ai u mbështet tek vargjet, fotografitë, dorëshkrimet, vendet, botimet e dokumenteve dhe krijoi një skenar i cili solli si rezultat një film që padyshim pranohet si një vepër artis-



tjetër shumë i rëndësishëm në procesin e shkuarjes së skenarit.

Nga eksperienca ime e bashkëpunimit të derisotëm mendoj se, sukcesi apo dështimi im si regjisor në filmat dokumentarë ka kaluar detyrësisht në këtë rrugë dhe në një masë të madhe është përcaktuar nga mbajtja apo mosmbajtja parasysh e këtyre momenteve gjatë shkruarjes së skenarëve.

Edhe diçka. Në dallim nga skenari i filmit artistik, i cili ndërtohet mbi ngjarje apo fakte reale por edhe të trilluara, të veshura artistikisht dhe që realizohet nga interpretimi i aktorëve në mjedis të improvizuara, skenari i filmit dokumentar ndërtohet mbi ngjarje dhe fakte konkrete nga jeta dhe realizohet duke xhiruar njerëz konkretë, njerëz që jetojnë e punojnë në vende konkrete. Kjo, kursesi nuk i heq të drejtën e

tike shumë e mirë e regjisorit Gëzim Erebara.

Kinematografia shqiptare, ndonëse e re dhe pa eksperiençë, gjatë këtyre viteve ka realizuar mjaft filma dokumentarë të cilët tani mund të konsiderohen krijime dinjitoze. Filmat tanë të parë "Letër nga fshati", "Pranvera e nëntë", "Buka"... filmat e mëpastajmë "Dritë mbi Shqipëri", "Pusi 542", "Qyteti i 1000 dritareve", "Aleksander Moisiu"... apo filmat e fundit "Ringjallje", "Migjeni"... e dëshmojnë më së miri këtë.

Së fundi, filmi dokumentar meriton më shumë vëmendje, si nga ne kineastët që kemi marrë pjesë për të fiksojmë në ekran historinë, jetën dhe punën e popullit tonë, ashtu dhe nga shkrimtarët e gazetarët që e duan filmin dokumentar dhe dëshirojnë të mirën e tij.

E Hënë, 10 Korrik 1972

Sot është një ditë e shënuar në jetën e kinematografisë shqiptare.

Plot njëzet vjet më parë, më 10 Korrik 1952 u shfaq për herë të parë në ekran kinoshkollurin Nr. 1 "Nëpër vendin tonë", prodhim i Kinostudios "Shqipëria e re", i pari në jetën e kinematografisë shqiptare, realizuar tërësisht nga krijues shqiptarë.

Endri Keko, Xhanfise Cipi, Hamdi Ferhati, Sokrat Musha, Mandi Koçi, Jani Nano, Agim Fortuzi, Ibrahim Uruçi, Koço Tollo, Milto Vako, Petraq Lubonja, janë emrat e krijuesve që gjenden në titrat e kinoshkollurin, ndërkohë që, për realizimin e tij kanë kontribuar edhe mjaft të tjerë... asis-

tent operatorët Mehmet Kallfa e Niko Theodhosi, montazhieret Bisen Behri e Angelina Uli, disenjatorja Gjinovefa Heba, shefi i laboratorit Mihal Çarba, laborantët Shyqyri Metani, Lumturi Bakllava, Kosta Kavaja, Mehdi Kapidani e Liri Karabina, teknikët e zërit Vangelj Leka, Besim Kukali, Lavdi Fortuzi e Xhavit Vathi, elektrikisti Ramadan Rushiti, shoferët Hamdi Kullojka, Rexhep Huma... Shpresoj të mos kem harruar ndonjë nga bashkëpunëtorët e ditës së parë. Nëse po, do të më vinte shumë keq e do t'i kërkova ndjesë, pasi, secili prej tyre meriton respekt për kontributin që dha në vendosjen e gurit të parë, atij të themelit të kinematografisë shqiptare.

Nga ajo ditë kanë kaluar dy dekada. Kutitë me kinokronikat tona të para që dikur qëndronin të vetmuara në raftet e zbrazëta të kinoarkivit, sot i rrethojnë mijëra kuti filmi që mbajnë etiketat Kinostudio "Shqipëria e re". Në të gjetend historia e Shqipërisë. Bashkë me të, edhe historia e kinematografisë shqiptare. Këtu çdo gjë të zgjon kujtim më vete e të fut në mendime për atë punë të madhe që është dashur të bëhet për të kaluar nga kinokronika e parë tek kinoshkollurini i parë dhe nga filmi i parë dokumentar tek filmi i parë artistik. Ishin vite kur ne dinim shumë pak gjëra nga profesioni i kineastit, por e dinim mirë se ne na kishte rënë barra të ngrinin kinematografisë shqiptare.

Në këtë ditë feste, si një ndër të parët e kinematografisë shqiptare ndjekem mirë. Në njëzet vjet, me punën tonë të cilën e nisëm nga hiqi, bëmë që filmi dokumentar shqiptar të krijojë individualitetin e tij. Përvoja e derisotme më thotë se, kur zemra e kineastit ka rrahur fort me zemrën e njerëzve, ai ka realizuar filma dokumentarë që i kanë vënë spektatorët në mendime.

Sigurisht, ka dhe raste kur... Por, sot është ditë feste dhe si e tillë ajo meriton të festohet. Analizën për dobësitë dhe të metat, njëherë tjetër.

E Shtunë, 23 Prill 1977

Sot paraditë, përfundoi Festivali II - të i Filmit Shqiptar i cili nisi më 16 Prill.

Gjatë ditëve të festivalit, organizuar në kuadrin e 30 vjetorit të kinematografisë shqiptare (u bëjnë disa kohë që si datë e krijimit të kinematografisë shqiptare festohet krijimi i Ndërmarrjes Kinematografike më 1947 e jo ajo e inaugurimit të Kinostudios më 1952), u shfaqën prodhimet më të mira të vitit të fundit. Gjithsej... shtatë filma artistikë, katërmëdhjetë filma dokumentarë dhe dy filma multiplikativë.

Në mbyllje të festivalit, juria shpallti filmat fitues të cilët u ndëruan me kupën e festivalit... filmin artistik "Lulëkuqet mbi mur", filmin dokumentar "Populli në këmbë, Partia në ballë" dhe filmin multiplikativ "Pika e ujit".

Gjithshka shkoi sipas parashikimit dhe surpriza nuk pati.

Në fund, si dokumentarist, meqenëse më tërheq kërraba nga ana e filmit dokumentar, po shkruaj dy fjalë për ta.

Për shtatë ditë, i pashë të gjithë filmat e planifikuar. Sipas mendimit tim, pashë mjaft filma dokumentarë të mirë të cilët treguan se ai pari në jetën e kinematografisë shqiptare, realizuar tërësisht nga krijues shqiptarë.

Endri Keko, Xhanfise Cipi, Hamdi Ferhati, Sokrat Musha, Mandi Koçi, Jani Nano, Agim Fortuzi, Ibrahim Uruçi, Koço Tollo, Milto Vako, Petraq Lubonja, janë emrat e krijuesve që gjenden në titrat e kinoshkollurin, ndërkohë që, për realizimin e tij kanë kontribuar edhe mjaft të tjerë... asis-

tent operatorët Mehmet Kallfa e Niko Theodhosi, montazhieret Bisen Behri e Angelina Uli, disenjatorja Gjinovefa Heba, shefi i laboratorit Mihal Çarba, laborantët Shyqyri Metani, Lumturi Bakllava, Kosta Kavaja, Mehdi Kapidani e Liri Karabina, teknikët e zërit Vangelj Leka, Besim Kukali, Lavdi Fortuzi e Xhavit Vathi, elektrikisti Ramadan Rushiti, shoferët Hamdi Kullojka, Rexhep Huma... Shpresoj të mos kem harruar ndonjë nga bashkëpunëtorët e ditës së parë. Nëse po, do të më vinte shumë keq e do t'i kërkova ndjesë, pasi, secili prej tyre meriton respekt për kontributin që dha në vendosjen e gurit të parë, atij të themelit të kinematografisë shqiptare.

Nga ajo ditë kanë kaluar dy dekada. Kutitë me kinokronikat tona të para që dikur qëndronin të vetmuara në raftet e zbrazëta të kinoarkivit, sot i rrethojnë mijëra kuti filmi që mbajnë etiketat Kinostudio "Shqipëria e re". Në të gjetend historia e Shqipërisë. Bashkë me të, edhe historia e kinematografisë shqiptare. Këtu çdo gjë të zgjon kujtim më vete e të fut në mendime për atë punë të madhe që është dashur të bëhet për të kaluar nga kinokronika e parë tek kinoshkollurini i parë dhe nga filmi i parë dokumentar tek filmi i parë artistik. Ishin vite kur ne dinim shumë pak gjëra nga profesioni i kineastit, por e dinim mirë se ne na kishte rënë barra të ngrinin kinematografisë shqiptare.

K
KUJTIME

Autori është një nga osmanologët më të mirë në vend me një kontribut të jashtëzakonshëm. Në këtë kontribut të tij kemi punimin mbi një shkrim, botuar nga gazetari i mirënjohur turk Hikmet Feridun Es, në gazetën "Aksham" (Stamboll), dhjetor 1944-janar 1945 me titull: Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigant mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit). Ne kemi vendosur ta botojmë në dy numra për shkak që të ruajmë të plotë të gjithë strukturën e tij...

"Çuditë" e Sami Frashërit

"E dëgjoji një orë në acar lypësin, sepse fliste mrekullisht arabisht"

NGA HIKMET FERIDUN ES
DHE KUJTIM NURO

Vijon nga numri i shkuar

MOS MERRNI PLUHURAT E DHOMËS


Megjithëse ishte një njëri jash-tëzakonisht i rregullt, në shkallen më të fundit, burri me i qetë i botës, marrja e pluhurave të dhomes dhe tavolinës që punonte, si dhe zhvendosja e letrave e nervozonte atë në mënyrë të jashtëzakonshme. Edhe zhvendosja e një letre nga vendi, bile dhe ndryshimi i vendosjes së një libri mund të dëmtonte punën e tij. Me të parë marrjen e pluhurave në dhomën e tij do të pyeste: Përseri janë ngatërruar librat dhe doreshkrimet e mija? Ai ishte një person i pashëndetshëm, në atë shkallë që do të habiste dhe atë dhe kishte çdo lloj sëmundjeje. Për ketë arsye, ishte e domosdoshme marrja e pluhurave dhe ajrimi i dhomës së tij. Për ketë, vajza kishte gjetur një mënyrë lehtësimi. Kishte marrë zarfa të vegjël dhe doreshkrimet, letrat, shenimet i vendoste veç e veç brenda tyre, duke mos i dhënë kështu mundësi as humbjes, bile as të një copëze letrë me të vogël.

MIQTË, TË CILËT VININ MBSADITE TEK SAMIU .

Sami Frasherit nuk e ka prere asnjëherë mjekren. Nuk shkante tek berberi. Atë e rregullonte vetë me doren e tij dhe çdo mengjes e lante me sapun. Ngrënia vazhdon-te dy ore e gjysmë. Nuk vendosi asnjëherë zarzavate në gojë. Lypësi, të cilin e dëgjoji një orë nën deborë sipër ures. Letrat, të cilat u shkruan në shtatë gjuhë. Njëri, i cili, morri me shume letra. Postieri i ndaluar.

DARKA NË SHTËPINË E SAMIUT

Kjo formon dhe një nga kapitujt me të rëndësishëm të jetës ditore të djetarit të madh. Në atë kohe, ndofta askush në shtëpinë e tij, nuk qëndronte kaq shume në sofër. Por, në shtëpinë e Samiut, darka vazhonte dy ore, ndonjëherë dhe dy ore e gjysmë. Djetari tregonte kujtimet e tij gjatë internimit, i cili kishte bërë në Trabullusin Përdimor (Tripoli - K.N.), anekdotat me të qeshura. Kështu ishin shumica e mbremjeve, në kohën që kryekuzhinieri tregonte të gjitha përgatitjet. Ai i kishte dhënë Sami Frasherit, emrin "Pejgamber". Në fillim do të vinte supa, pastaj me shumicë peshku. Sami Frasherit nuk vendosi në gojë zarzavatet. Ai,



ketyre u kishte venë emrin "bar-ishte". Nuk përdori asnjëherë në mënyrë kategorike vajin e ullirit. Pëlqente shume byrekun, vëcanërisht byrekun me spinaq dhe pitën me brume të ardhur. Përkundrejt ketyre, e urrente zakonisht pilafin. Gjatë dimrit, jashtë në kohën që debora binte qetë-qetë dhe floke -flope, gjeja e pare që vinte në sofër, ishte supe tërhanaje me pipër të kuq dhe e nxehtë, brenda një tasi të madh porcelani. Ky tas përdorej vetëm për supen. Mbas ngrënjes, e cila vazhonte deri dy ore e gjysmë, ulej dhe do të shtrihet menjëherë, në oren me të hershme të mbremjes, sepse ishte e nevojshme të ngrihej herët, përpara se të lindte dielli. Në krye të krevatit ishte vendosur një shandan dhe një mbështetëse trekëndore. Sipër kesaj mbështetëse lihehin shisha-ja e bojes, e cila nuk derdhej, një penë, ora e madhe që e ka përdorur gjatë gjithë jetës dhe letra me ngjyre blu të fortë. Në kohën që shtrihet, tërhiqte deren duke thënë: Zotëri, Perendia të dhentë qetësi!

AFËR MBRËMJES, VININ MIQ NGA INDIA

Mirepo, shume here, puna nuk ishte kështu. Në kohën që ora ishte 11.30 e mbremjes, dera trokiste: tak-tak. Menjëherë do të shikoje gjashtë persona, zakonisht në gjendjen e një delegacioni, një grup miqsh të ardhur nga Afganistani, sepse shkencetari i gjuhësive njihet në të gjithë botën Lindore. Ai,

nga të folurit me shkencëtarët e ardhur nga vende të largëta. Bile, ndonjëherë, do të ishin misafire për javë të tëra, ndonjë, do të ishte misafiri i tij në mënyrë të vazhdueshme, si Mesuti nga Tunizia.

LETRAT E SHKRUARA NË SHTATË GJUHE TË VEÇANTA

Jo vetëm misafiret, por dhe letrat e tij ishin mjaft interesante. Djetari ishte njeriu i kohës, i cili merrte me shume letra. Numri i letrave që ai merrte aq shume, ishte i atille, sa që do të bentë xheloz dhe yjet e sotme të kinematografise. Nga që përgatiste fjalorë të lidhur me Lindjen dhe Perëndimin, i vinin letra në gjuhë të ndryshme, nga vendet me të largëta të botës, nga qytete të Afrikes dhe të Azise, që nuk e pristë. Keto, shumica e tyre ishin të dhena për vendet, njerëzit, ngjarjet, të cilat i duheshin për fjalorët që po përgatiste. Për llogari të Samiut, punonte një Lindje dhe atij i dergoheshin të dhenat. Ashtu sic i bejnë institucionet e sotme modernë të shkencës, dhe Samiu do të ndihmohej prej tyre. Djetaret, mendimtarët dhe intelektualët, të cilët vinin në ketu, ishin ata, që ai kishte me se shumti letërkembimin. Bile, dhe letrat që vinin, ishin shtuar aq shume sa Sami Frasherit kishte një shërbim të posacem postar. Një njëri ishte caktuar vetëm për ketë punë. Samiu, mbasi mbaronte shkrimin, u shkruante përgjigje letrave që merrte. Ndonjëherë letrat, të cilat shkruante, ishin të ndara vec e vec, në shtatë gjuhë. Njeriu e Sami Frasherit, i cili jepte në postë dhe që merrte nga posta 15-20 letra në një ditë, bile kishte dyshuar për ketë letërkembim dhe e kishte ndaluar. E kishte shpetuar njëherë njeriun e dhimbshëm, që ishte ndodhur në një gjendje të veshitë. Interesimi i gjuhës nuk qëndronte vetëm në shkrimin e letrave në shtatë gjuhë gjatë letërkembimit me miqtë, të cilët i shkruanin keto gjuhë, por dhe në përgatitjen e fjaloreve. Me poshtë, po tregojmë një kujtim tregon se sa shume Samiu përipiqej për gjuhën shkencore.

NËN RËNIEN E DËBORËS, KA DËGJUAR NJË ORË NË TË VOBËKTË

Debora binte shtruar-shtruar, floke-floke. Vajza e madhe dhe femije e tjerë të tij se bashku me babain e tyre, Samiun, po zbrisnin për një punë në Stamboll. Kjo është një nga ngjarjet e jashtëzakonshme të shkencetarit. Sepse, duke mos qenë i detyruar, ai nuk zbriste në Stamboll. Akoma me tepër, për

shkak të shendetit të tij të dobët, në shkallen me të fundit, nuk dilte shume nga shtëpia në kohën me debore dhe me shi. Babai me femijet po kalonin nga ura, ku kishte grumbuj njëzërisht. Në atë kohe, ura Karakoy ishte "një galeri të mjeresh". Kishte nga ata, të cilët degjonin lutje të cdo lloji, të cdo lloj kombesie dhe nga cdo lloj gjuhe. Duke qenë se ishte ftohtë, në kohën që Samiu po ectë shpejt e shpejt, ndalon përnjëherësh përpara një të mjeri . Po e degjonte atë, duke thenë lutje në gjuhën Arabe. Samiu, menjëherë u kthehet femijve të tij: Një Arabishtë e mrekullueshme. Ky njëri është nga ata që e flet me bukur Arabishten, që ka theksin me të bukur të gjuhës Arabe. Degjoheni me vëmendje! Dhe se bashku me femijet, ai si dobet që ishte, që trembej nga të ftohtit, që vuanet nga ajo kohe, plotësisht një orë, nën renien e debore shtruar-shtruar, floke-floke, po me të vërtetë po degjonte të vobektin, i cili thoshte në një mënyrë të mahnitshme, lutje dhe poezitë me të vjetra në Arabisht. Bile, u beri me shenjë femijeve ku ndodheshin dhe u thotë: - Ndoshita, a nuk mund ta marrim në shtëpi ketë burrë për t'iu mesuar juve gjuhën Arabe. Ja, Samiu, në ketë mënyrë, nën renien e debore, për të mesuar dicka të re, do të degjonte të vobektin, të cilët recitonin mbi ure, lutje në gjuhë e tyre të vëcanta me njëra-tjetren. Samiu ishte gati t'i merrte ata në shtëpi. Me trupin e tij shendetlig, një orë nën renien e debore për të degjuar Arabishtën e të vobektin, i kushtoi atij një e ftohur e rende. Por, ai, përseri, ishte i kenaqur për ketë. I vobekti, nuk u muarr në shtëpi, por Mehmeti nga Tunizia, i cili dinte mjaft mire shume gjuhë të huaja, u vendos në shtëpi. Në ketë mënyrë, shtatë femijet që ndodheshin në shtëpi, dhe 2 femije të tezes, në cdo 15 ditë, një nga një do të merreshin në provim për gjuhët që kishin mesuar nga Samiu. Samiu, gjatë mesimit të gjuhës se huaj, kerkonte që asnjë person, sado gjuhë të vëcanta apo shume gjuhë, nëqoftëse dinte, të mos i ngatërronte me Turqishtën. Psh: Edhe pse e dontë shume gjuhën Arabe, nuk dëshironte përzjerjen e fjalëve Arabe me fjalet Turqisht. Përballë stafit të gazetës "Servet-i Funun", ai thoshte: -Keta femije do të përparojnë shume, por gjuha Turke duhet të thjeshtëzohej. Hyselin Rahmiu e dontë shume.(shkrimtar Turk : 1864- 1944-K.N.)nga që i afrohej shume gjuhës se të folurit.

Në 140-vjetorin e lindjes së Aleksandër Moisiut, botuesi i "Argeta-LMG" flet për mënyrën sesi po investohet për të sjellë përkujtimin e aktorit të madh të botës gjermanike me origjinë shqiptare, Aleksandër Moisiu.

I INTERVISTA

NGASTAF "MILSOAO"

Intervistë me studiuesin dhe botuesin e Jetës dhe Veprës së Aleksandër Moisiut - Mehmet Gëzhilli, drejtor i shtëpisë Botuese "Argeta - LMG"

TAKIMI I PARË ME ALEKSANDËR MOISIUN

Parafytyroni një çunak trembëdhjetë, pa mbushur katërm-bëdhjetë vjeç, që e ka çuar halli nga një fshat i largët i Oparit në Maliq të Korçës për të blerë një gjilpërë olioze për vëllanë që e kishte shumë sëmurë. Ishte vjeshta e vitit 1957, pra, këtu e mëse gjashtëdhjetë vjet më parë.

Ato vite hidheshin huatë shtetërore dhe herë pas here shlyeshin duke e shpallur numrat fitues në gazetën "Bashkimi". Dhe familja e tij në skamje dhe varfëri ekstreme kishte huajtur diçka për të ndihmuar shtetin.

Dhe ja, nga ajo hua-llogari kishte fituar një 500 lekëshe. Biletën e huasë e kishte marrë me vete, shkollë në postën e qytetit, tërheq 500 lekëshin dhe prej andej shkollë në vetmin dyqan që kishte Maliqi, ku tregtoheshin të gjitha gjërat, rroba të gatshme, stofra, basma, në një anë tjetër shitej vaj, sapun, gozhdë e gjithë çka i nevojitej njeriut.

Në një cep të një banaku gjithë pluhur ishin edhe disa libra. Me 500 lekëshin që fitoi, çunaku, pasi u hoqi pluhurin, filloi t'i shikojë librat si i babëzitur dhe zgjodhi gjashtë copë; "Nënë" e M. Gorkit, "Qiriun" e Gjilë Kuqalit (dëshmor), "Flamurin e grisur" të Selman Vaqarrit, "Sonda dhe Morsuja e pësojnë", poemë në vargje e një poeti sovjetik dhe "Feminija e Nikitës" e Aleksej Tolstoit, si dhe monografinë e Selman Vaqarrit "Aleksandër Moisiu" që ishte botuar po atë vit. Libri i fundit që bleva, dhe nuk e di se pse u sugjestionova aq shumë, ishte për rritjen e kultivimin e domates. Kjo ndosh-ta, ngaqë nëna i kultivonte dhe kishte një kopësht shumë të mirë, që ia kishte zili gjithë fshati.

Pra, ky që takimi i parë i imi me Aleksandër Moisiun, ku çdo gjë që mundohesha të lexoja për mua ishin krejt të panjohura.

E ç'mund të kuptonte një çunak, që sapo kishte mbaruar shkollën fillore, por të gjashtë librat i ruaja si gjënë më të shtrenjtë.

Takimi i dytë me Moisiun

Pasi mbarova shtatëvjeçaren dhe shkova në Shkollën Pedagogjike të Korçës, në vitin 1960, na vjen aktori i mirënjohur korçar Dhimitër Orgocka dhe ne, një grupi nxënësish na flet për jetën dhe veprën e Aleksandër Moisiut.

Se me çfarë zjarri na foli Taqka (kështu i kemi thirrur gjithë jetën Dhimitri) për Moisiun, edhe sot më është ngulitur në mendje interpretimi i tij. Ai ishte që atëherë aktor plot talent, të sugjestiononte, dhe aq më tepër, la gjurmë të mua, që pata fatin të kisha lexuar

një libër për Moisiun, por pa e ditur mirë se çfarë kisha blerë vite më parë.

Biseda e Dhimitraq Orgockës për Aleksandër Moisiun ishte takimi i dytë me artistin.

Më vonë, kur u njoha më gjerë me jetën e Moisiut dhe fillova të studioja gjithë çka, kuptova se bisedat për Aleksandër Moisiun në vitet gjashtëdhjetë bëheshin në gjithë Europën e më tej, me vendim të Komitetit Ndërkombëtar të Paqes në përkujtim të 25-vjetorit të vdekjes së këtij aktori botëror.

Në nderim të tij, shteti shqiptar mori disa vendime, duke e shpallur të parin, Aleksandër Moisiun, Artist i popullit, Dega e dramës në Institutin e Arteve në Tiranë mori emrin e tij. Teatri i Durrësit u emërua po me emrin e tij, u organizuan konferenca shkencore, u bënë takime të posaçme, bile edhe në gjuhë të huaj.

Prej atëherë e në vazhdim, jeta e Aleksandër Moisiut po bëhej përherë e më e njohur dhe e afërt, duke pasuar një sërë botimesh, jo vetëm në shtypin e kohës, por edhe në vepra e monografi të plota.

Po cilët janë autorët shqiptarë, që janë marrë posaçërisht me jetën e Moisiut?

Që para çlirimit, shtypi shqiptar dhe i huaj e ka pasqyruar gjerësisht jetën e artistit, por ai që e ka takuar dhe parë në skenat e Vjenës, për të cilin ka shkruar tre artikuj, që bile kanë karakter studimor, është profesori i gjithanshëm Vask Samimi. Këto artikuj-studime janë ribotuar në vepër në plotë të tij.

Në vitin 1957 doli vepra e Selman Vaqarrit. Në vitet gjashtëdhjetë u pasua me një vepër monografi nga prof. Bardhyl Kosova, e cila pati disa ribotime si në Tiranë, edhe në Prishtinë. Bile kemi të dhëna se pushteti serb ka arrestuar dhe burgosur studentë kosovarë të cilëve u është gjetur ai libër.

Me jetën dhe veprën e Moisiut është marrë gjerësisht kushëriri i tij, Vangjel Moisiu, vepër që përveçse në shqip, është botuar edhe në anglisht dhe italisht.


Në Kosovë është botuar një vepër tjetër nga gazetari i kulturës Shaqir Foniqi. Për Moisiun është botuar edhe një album në disa gjuhë.

Po nga autorët botërorë, kush është marrë me jetën dhe veprën e artistit?

Shumë personalitete kanë shkruar monografi, drama, i kanë kushtuar shumë vepra të artit, por ajo që dua t'ia bëj të njohur lexuesit është një libër-album i veçantë për vlerat që përmban.

Vepra është botuar në Berlin, në gjermanisht, në një botim luk-si, i futur në kuti dhe që çdo ekzem-plar ka numrin e vet. Gjithsej janë shtypur 250 copë dhe mban vit të imi vitin 1927.

Të pathënat e figurës së Aleksandër Moisiut?!



Mesa duket, ky botim special është bërë si dhuratë për aktorin. Libri mban titullin: "Moisiu - njeriu dhe artisti, me fjalë dhe foto. Mbledhur nga Hans Bëmi". Libri përmban vlerësimet e 40 personaliteteve të artit e të kulturës botërore. Janë përfshirë edhe tre shkrime të vetë Aleksandër Moisiut. Shogërohet me vizatime nga piktorë të njohur të kohës, Emil Orlik, Henrik Lund dhe Kepreluk. Libri është i ilustruar me 104 fotografi që pasqyrojnë jetën e aktorit në të gjitha aspektetë saj.

Në 104 fotot e aktorit a mund të veçonit ndonjërin më mbresëlënësen?

Çdo foto të ngjall befasira, që vetëm adhurim për aktorin të sh-

lamtumirës pas një shfaqjeje turne"; F. Shaljamin: "Djali ynë"; F. Saver: "Erosi dhe Karitasi"; A. Boserman: "Vuajtja e përbashkët dhe gëzimet"; F. Molnar: "Zogu shtetg-tar Moisi".

Për Moisiun kanë shkruar në këtë libër shkrime regjisorët e tij dhe bashkëautorët më të shquar.

Këtë libër e kanë shfrytëzuar shumë studiues, por rrallë e kanë përmendur. Pas nëntëdhjetë vjetësh, lexuesit shqiptarë do të kenë fatin që ta kenë në dorë një shqip nën përkthimin e saktë dhe me pasion e dashuri nga z. Elda Gjana.

Në këtë vepër që s'i kalon një-qind faqe, çdo fjalë dhe fjali është si gurëz zhevhahiri që lëshon rreze e mirësi për artistin tonë të madh, që antikëve grekë, veprat e të pa-përsëriturit Shekspir, Tolstoj, Gëtes e Shilerit, Pirandelos, etj., etj., u foli në gjuhën e vet, duke tronditur shpirtat njerëzorë, nga Berlini, Vjena, Praga, Bukureshti e Beogradi, Parisi e Londra, Roma dhe Trieste, e deri në Argentinën e largët.

Aktori i mirënjohur, i ndjeri Minella Borova, që shkoi deri në Buenos Aires, më tregonte dikur se në teatrin e kryeqytetit argentin kishte gjetur gjurmët e Aleksandër Moisiut nëpërmjet kujtimeve dhe fotografive, të cilat do të m'i dërgonte një ditë, por ai "fluturoi" krejt papritur për në botën e përtejme. Mbeti një peng për të dhe për mua, por ndoshta një ditë dikush do të kujtohet dhe do të na i dërgojë ato fotografi, duke e pasuruar fondin e artistit.

A pati edhe Aleksandër Moisiu ndonjë peng të paralelluar?

Po, pati. Ai mund të ketë patur shumë, por njërin e dimë mirë, sepse e ka shprehur edhe në shtypin e kohës. Në vitet njëzetë-tridhjetë ai dëshironte të vinte në Shqipëri si aktor botëror, që bëhej, por edhe si bir i thjeshtë i popullit të vet. Ai deklaronte me dhimbje se në Shqipëri nuk kishte skena për të dhënë shfaqje, por ai kishte parashikuar që të jepte një program me recitime, me pjesët më të zgjedhura të repertorit të tij.

Nuk e dimë se përse nuk e realizoi këtë ëndërr, por s'dimë që në vitin 1933, së bashku me të shoqën, aktoren dhe partneren e tij, Johana Terwin, shkoi në ambasadën shqiptare në Vjenë dhe kërkoi shtetësinë shqiptare.

Si është e vërteta e shtetësinë shqiptare që kërkoi Moisiu?

Moisiu ndiqej dhe persekutohej nga nazistët. Ai e ka shprehur me forcë të jashtëzakonshme qendrimin e tij anti-nazist në dramën e tij, ku ka luajtur edhe vetë "Robi", kushtuar fundit tragjik të Npoleon Bonapartit. Në atë dramë donte të thoshte se edhe Hitleri ashtu do të përfundonte, si rob, si

Të mëdhenjtë e shekullit XX për Moisiun

FRIC ENGEL TRIDHJETËVJEÇARI

Kush është aktori më i shumëpërmendur i Berlinit të sotëm? Dhe kush është njëkohësisht, ç'ka për të vetë nuk do të jetë e pakëndshme, aktori më i mirëpaguar? Kujt i hedhin lule në podium bijat e atyre nënave, të cilat dikur adhuronin Josef Kaincin? Është një burrë, me një shtat pothuaj mesatar, me shpatulla të holla dhe pa pulpa heroji. Duhet të shohësh të ndriçojnë vetëm sytë e tij të mëdhenj të vendeve të jugut, dhe duhet të dëgjosh orkestrën melodike të organit të tij, për të kuptuar magjinë, e cila i valëvitet atij përreth si një mantel i bukur. Është Aleksandër Moisiu, i cili ka ardhur në Vjenë si statist nga bregdeti i Triestes, as nuk e zotëronte gjuhën gjermane, kur u zbulua atje nga Maks Rajnhardt, shumë herët u shfaq në rolet e mëdha të skenës së "Teatrit Gjerman", për këtë arsye në fillim u pranua me rezervë, madje u refuzua, dalëngadalë u mësuara me detyrat e tij dhe tani: është i pari. Për mijëra njerëz ai është tanimë bartësi i stolive më të çmuara, i cili është i aftë tu japë aktorëve të mëdhenj artin poetik dramatik. Ai është Romeoja dhe Marquis Posa. Ai është Hamleti dhe Princ Hajnci. Ai është Oresti dhe Edipi. Ai luan Franc Morin dhe Riccaut. Kordat e tij lirike tingëllojnë ende të plota, por tashmë prej vitesh nga ai vërshon një seriozitet më i fuqishëm artistik. Vërehet se ai nuk do të luajë vetëm dashuri

Bonaparti.

Moisiu e kërkoi shtetësinë shqiptare për t'i shpëtuar ndjekjes dhe persekutimit, nga emri që mbante. "Moisi" ngjallte dyshime dhe xhelozë.

Shteti shqiptar ia dha menjëherë shtetësinë shqiptare, së bashku dhe shoqësi së tij, Tervin.

Disa faqezinj, që duan të nxijnë gjithçka rreth vendit të tyre janë shprehur se shteti shqiptar nuk i ua dha shtetësinë, por dokumentet që ndodhen në Arkivin Qendror të Shtetit tregojnë krejt të kundërtën. Edhe një thashethem gjoja se mbreti Zog deshi ta merrte në pallatin mbretëror për organizimin e ceremonive, nuk qëndron. Thjeshtë kanë qenë shpifje, shpifje për të denigruar qoftë njerin, edhe tjetrin.

Dy vite, dy përvjetorë: 2019-a, viti i 140 vjetorit të lindjes dhe viti i ardhshëm 2020, viti i 85-të i ndarjes nga Jeta, si studiuues dhe bibliograf i veprës së Moisiut, ç'mendoni se duhet bërë?

Kjo është shumë e thjeshtë dhe konkrete. Duhet shpallur nga shteti "Viti i Aleksandër Moisiut" Prill 2019 - Prill 2020.

Po flitet shumë për vlerësimin dhe gjallërimin e jetës në diasporë. Po a ka më përfaqësues të denjë se ç'na ka përfaqësuar Aleksandër Moisiu nëpër botë, i cili kudo ku ka patur rast të takojë shqiptarët ka shprehur krenarinë e tij si shqiptar dhe dhembshurinë e mallin

dhe se ai gjithmonë i ngre sytë me më shumë gëzim nga figurat e mëdha, të cilët janë bartës të një mendimi të madh etik dhe zëdhënës të një botëkuptimi. Kështu sot në skenë qëndron ai, djaloshi i dashuruar nga gratë e megjithatë një burrë, të cilin e vlerësojnë burra seriozë, tanimë i përkëdhelur tepër nga fama dhe për këtë arsye nganjëherë i rëndë, por një gjeni! Dhe prapa tij valëvitet një e ardhme si një perde enigmatike e shkëlqyeshme, dhe prapa kësaj perde të reja, të cilat ai do t'i ajrosë dalëngadalë.

Berlin, shkurt 1914.

GERHART HAUPTMANN

Agnetenodorf, 17 qershor 1927 Vizenshtajn

Midis aktorëve të mëdhenj të Gjermanisë veçantia e Moisiut është e qartë. Më shumë sesa të gjithë të tjerët të kjo veçori bazohet talenti i tij. Si drejtimi në një violinë të Stradivarit, kur një

mjeshtër luan Bethovenin, është njëkohësisht melankolik, i gëzuar dhe i zjarrtë, kështu është shprehja e shpirtit të Moisiut, kur ai e vë atë në shërbim të një veprë poetike. Midis përjetimeve të mëdha të artit të tillë në krye më qëndron Montezuma e tij në pjesën "Shëlbuksi i bardhë"; vetëkuptohet, meqenëse unë pikërisht të kjo figurë mund të gjykojë pushtetin e brendshëm të forcës interpretuese të Moisiut.

BJËRN BJËRNSONI

Oslo, 15 qershor 1927

Moisiu është incizuar në zemrat tona – sepse zëri i tij tingëlton si muzika e bukur në vuajtje dhe në gëzim.

Dhe tingullin e kësaj muzike në e fshehim njësoj si një akord i mrekullueshëm në kujtesë.

LUIGJI PIRANDELO PËRSHËNDETJE DHE FTESË

Maj 1927

Përshëndes patriotin tim të madh Aleksandër Moisiun, të cilin e ndjej për detyrë që ta falënderoj përherë si një nga interpretuesit më të përkryer të shumë personazheve të mi. Para së gjithash më ka ardhur thëllësisht keq, i dashur Moisi, që Henrin Tuaj të IV-ërt, i cili, siç më kanë njoftuar; ishte interpretimi më i bukur, që ka patur ky rol, nuk mund ta admiroja personalisht. Dhe unë shpresoj që ju të vini së shpejti te ne në Itali të na shfaqni Henrin Tuaj dhe personazhet e tjerë të shumë, që i ka ripërtërirë gjenia Juaj. Ju shtrëngoj dorën fort nga larg miqësisht. (përkthyer në gjermanisht nga Hans Fajstl)

HERMAN BARI

Çfarë fati për ne, të kemi Moisiun! Figura e tij e shndritshme kudojet që në Perëndim të mos shuhet koncepti i hijeshisë, i hijeshisë që dhuron fat, i hirrit që shkel kujdesin, që qetëson

trazirat, që freskon zemrën, që magjeps shqisat dhe pikërisht nëpërmjet kësaj hijeshia çliruese nga të gjitha torturat dhe tisi, koncepti i hijeshisë më të dashur dhe në zemërbutësinë e saj të ëmbël njëkohësisht më të fortë nga të gjitha dhuratat e Perëndive, megjithatë edhe sot ende, në pikëllimin e paralizës së përgjithshme shpirtërore dhe të pëshptjelimit shqisor! Erosi dhe Psika (bashkëshortja e Erosit) janë martuar brenda tij, dhe tashmë grekët fëmijën e këtij takimi të ëmbël e njohën me emrin: quhet lumturi.

KLABUND MUZIKANTI I PERËNDISË

Kur muzika është ushqim për dashurinë – thotë Shekspirin. Por muzika nuk është vetëm ushqim i dashurisë – ajo është ushqim, forcë nxitëse, moti i çdo arti. Muzika duhet të jetë brenda tij, thotë berlinezit. Dhe ajo është brenda tij. Muzika është brenda Aleksandër Moisiut. Gjuha e tij këndon, në sytë e tij ajo zuka, trupi i tij tingëlton. Atij, kur njeriu hesht në torturën e tij, i thotë një Perëndi se çfarë po vuan. (Tasojë i tij është i paharrueshëm) Po, më shumë e thënë sesa e krijuar. Ai është një këngëtar. Këngëtarin më magjepsës i gjuhës gjermane. Dhe meqenëse muzika flet një gjuhë ndërkombëtare: kështu nuk është asnjë çudi që Moisiu është bërë aktori gjerman më ndërkomëtar dhe pra në botë aktori gjerman më popullo.

FEDOR SHALJAPIN "DJALI" YNË

Pas një mbrëmjeje të lodhshme të shfaqjes turne në Operan Shtetërore të Vjenës... po darkej i lodhur në një restorant, atëherë dëgjoj befasi një zë të dashur, të këndshëm që thërret emrin tim. Duke u kthyer shoh "djalin" shpirtmirë, siç e quanim, dhe edhe herë një tingëllon përmesrisht "Fjodor Ivanoviç, i dashur Fjodor Ivanoviç... sa i gëzuar jam që po ju takoj këtu! - "Moisi", thërras unë, "I dashur Moisi, të përshëndes me zemër!"

Tërë mbrëmjen më tregoi për shokët e mi të mirë, për punën, teatrin, Rusinë, dhe lodhja ime kish të ikur. "Unë sapo jam kthyer nga atdheu juaj i mrekullueshëm", më thotë Moisiu, "kam luajtur atje teatër, shumë dhe me jehonë. Publiku juaj është shumë entuziast!"

Mbrëmjen tjetër në tetarin Popullor Gjerman shoh mikun tim në pjesën "Kontin ton Charolais", ai luan personazhin kryesor, emri i të cilit krijon edhe titullin e veprës. Dhe si e luan ai atë! Unë dola krejt i magjepsur nga shfaqja dhe i shastisur nga forca, e cila shpërbente nga trupi thuajse i ëmbël dhe i brishtë. "Bravo, bravissimo, Moisi!" kështu bërtita në pushime dhe në mbylljen e shfaqjes. Ishte e mrekullueshme dhe nuk do ta harroj kurrë mbresën mposhtëse të genies së tij. Mirupafshin, shoku im i dashur Mosi!

IDA ROLAND

Moisiu është një artist vërtetë europian. Përtej gjithë gjuhëve dhe kufijve vështrimi dhe gjetet e tij mbeten të kuptueshme për të gjithë, të cilët e ndjejnë sesi brenda fëmijnores takohen madhështia dhe dobësia, hyjnorja dhe njerëzorja.

Përktheu nga gjermanishtja: Dr. Elda GJANA-BORIÇI



për të parët e vet, për Kavajën e Durrësin? I paharruar është takimi me studentët në Vjenë, ku i porositi se puna dhe vetëm puna do t'i nxirrte në dritë.

Në këtë përvjetor të artistit cila do të ishte vepra që do të vultoste kulmin e saj?

Padyshim, ngritja e muzeut të Aleksandër Moisiut në Kavajë, në vendin dhe në parë të vet, por edhe aty ku është bërë pagëzimi i tij, që njihet nga dokumentat në kishën e qytetit.

Është deklaruar si nga kryeministri i vendit, zoti Edi Rama dhe nga institucione të tjera, se do të ngrihet Muzeu i Diasporës, në Korçë Muzeu i Rakisë, në Berat Muzeu i Verës, në kuadrin e zhvillimit të turizmit. Plotësisht të pëlqyeshme dhe të domosdoshme. Por ndoshta na jepet e drejta që të bëjmë, si qytetarë që jemi, edhe ndonjë sugjerim.

Ngritja e Muzeut të Moisiut në



Kavajë është domosdoshmëri për vlerat tona kombëtare, dhe qyteti i Kavajës do të merrte një vlerësim e një gasje turistike që s'do ketë shqiptar apo turist nga çdo cep i botës, që t'i bjerë rruga të kalojë në Kavajë e të mos ndalet të shohë

Muzeun dhe të pijë një kafe. Po si botues, çfarë gjëra të reja do të sillni në këta përvjetorë?

Ne si Shtëpi Botuese, në bashkëpunim me fondacionin "Moisiu", do t'u japim lexuesve shqiptarë tre vepra: Botimin në origjinal në gjermanisht dhe me përkthim në shqip "Moisiu - njeriu dhe artisti, me fjalë dhe foto", mbledhur nga Hans Bëni dhe përkthyer nga Elda Gjana. Vepra e dytë do të jetë "Vepra letrare e Moisiut", ku përmbledhim në rreth 250 faqe shkrime kritike, letrat, intervistat, drama "Robi", etj., dhe libri i tretë do të jetë "Antologjia poetike" me vargje kush-tuar aktorit nga autorë botërorë dhe shqiptarë.

Jeta dhe vepra e Moisiut, e shpërndarë si në Europë, por edhe në botë, është si një minierë, që sa më shumë të gërmohet, aq më shumë nxjerr mineral të cilësisë së parë.



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri mund të konsiderohet si një numër me materiale shumë interesante, por i zgjidhur jo shumë mirë grafikisht. Ngjante pak si numër politik-historik. Tema kryesore iu la kujtimeve të vajzës së Sami Frashëri për të atin e saj. Kujtim Nuro, një nga osmanologët më të mirë shqiptarë, që jeton jashtë vendit prej vitesh, kishte përgatitur shkrimin e një bashkëkohësi mbas të Rilindasit Hikmet Feridun Es. Redaktori e ka ndarë shkrimin me disa pjesë për shkak të gjatësisë. Shkrimi do t'i shërbejë shumë një njohtë për këtë figurë tëjet interesante të kulturës turke dhe shqiptare, apo për një nga Rilindasit më të vyer, kurse për turqit një nga intelektualët më të mëdhenj të shekullit të XIX. Shkrimi ishte botuar në gazetën "Aksham"(Stamboll), Dhjetor 1944-Janar 1945 me titullin: Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigand mendimtar, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit).



Ushtaraku kanadezo-shqiptar Kostandin Ristani e vazhdoi traktatin e tij që ndaloi tashtë dhe në fund "u kujtua" të na thoshte se i kishte pëllyer. Nuk mundëm t'ia botonim një copët, siç thonë në veri. Shkrimi ishte pak ex-cathedra dhe megjithëse ishte i artikulluar mirë dhe me tepër kulturë, i mungonte pakëz shprehja për individualitetin tonë kombëtar.

Arben Meksi, karikaturisti i njohur na solli një vështrim për Adrian Devollin, që sipas tij ka arritur një nivel në ekspozitën e fundit, falë kulturës së gjerë, pasionit për historinë, letërsinë, muzikën, njohësi i mirë i artit botëror, të hershem dhe bashkëkohor. Mund edhe të kursejë pak pasi shumë nga punët e autorit njiheshin nga kolegët.

Redaktori solli një përkthim të Olga Carlisle, në një shkrim gjysmë intervistë me Pastërnak. Intervistesja e shkrimtarit të njohur ishte një publiciste e njohur me origjinë ruse, e cila ka jetuar jashtë vendit të saj të origjinës dhe që shpjegonte takimin me Pastërnakun, autorin e njohur të "Doktor Zhivagos". Ajo e solli dikur me një përkthim shumë mbresëlënës për Paris Review. Ehtë një takim i kahershëm, por u dha si model prej nesh. Redaktori pati mundësi të shikonte pas redaktimit se ka bërë shumë gabime në përkthimin e parë, përgatitur 10 vite më parë.

Inxhinierët dhe studiuesit Genc Samimi dhe Dritan Çoku, dy njerëz që merren prej vitesh me Beratin alias "Qytetin e Bardhë", sollën për publikun ditët e fundit një libër të jashtëzakonshëm studimor në gjuhë dhe monografisë, me një material të detajuar për kishat e qytetit të famshëm por vetëm ato brenda Katasë së qytetit. Genc Samimi, restauratori veterani, e përshkruan me kujdes këtë situatë dhe amullin që ekzistonte para disa dekadash në kohën kur bënte punën e tij restauruese dhe konservuese në kalanë dhe qytetin e Beratit, kurse Çoku e ilustroi dhe e mbushi me shënime...Redaktori u mundua t'ua shprehte në këtë mënyrë mirënjohjen.

Qerim Vrioni, studiuesi i njohur i fotos, iu dedikua me një shkrim fotografit Ardian Fezollari, duke e cilësuar si të jashtëzakonshëm dhe duke i vlerësuar atij peizazhin fotografik. Autori e vlerësonte jashtëzakonisht, por redaktori mendom se pjesa lirike e fotografit flet më shumë për një ndikim poetik të qytetit, e që ndoshta meriton dhe një shkrim ndryshe. Gjithsesi, autori ka hapur udhë për këtë vështrim. E përsërisim ishte një numër i mirë, por layout sërish nuk punoi shumë me finesë. Redaktori është përgjegjës kryesor për këtë.

E

EKSPOZITA

Në këtë ekspozitë të fundit, specialistët vërejtën se Entoni ndër vite ka ndryshuar dhe sidomos përmirësuar jo vetëm idetë dhe perceptimin e materies, por edhe teknikën dhe sidomos disiplinimin para idesë. Të gjithë këta faktorë, që një pjesë e dashamirëve të tij, e lidhnin me fëmijërinë dhe me një kohë ku megjithë përkorjen ka pasur shumë dritë, e bëjnë pikturën e tij shumë vitale dhe që e kërkon bashkëbisedimin direkt me përfytyrimin që ngrihet të çdo shikues...

Enton Panariti, një rikthim te ngjyra

NGA STAF "MILOSAO"

Gati dy javë më parë, piktori Enton Panariti, iu përshfaq publikut në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar me ekspozitën e re "Hapësirë", forma dhe ngjyra", ku përmbledhi realizime të 10 viteve të fundit. Ajo që ngacmoi kërshërinë dhe gjykimin e të pranishmëve por edhe ndjekësve të tij ishte pa asnjë dyshim ngjyra. Autori gërshetoi botën e tij dhe përshkrimet e nënvetëdijes brenda një trekëndëshi gati bazik jetësor për të, pikave fokale me të cilat i dha frymë dhe ekspozitës. Dhe, hapësira, ngjyrat dhe forma ishin kufijtë e vetëm të idesë së tij për të sjellë një materie ideore me të cilën ai u prezantua në këtë stad të punës së vet.



Evolutioni i punës së tij përmbledh një vazhdimësi dhe një vizitor ka mundësi të kundrojë dhe detajet, apo si janë sjellë punimet e autorit me këtë materie në kohë të ndryshme. Entoni e përshfaq veten si një vëzhgues të kujdesshëm dhe jo vetëm kaq por edhe një artist me shumë përgjegjësi qytetare për idetë që e ngrëthejnë.

Perceptimi i përditshmërisë së jetës së tij duket se ka ngarkesën. Ngjyrat e kësaj ekspozite kërkojnë hapësirën e tyre por edhe mënyrën sesi përshkon konceptet penelata e autorit. Kontrastet që realizojnë ngjyrat kryesore të spektrit, si e kuqja, bluja, e verdha, bardhë, e zezë na shpërfaqin një autor me vlera por edhe një njeri që e ngacmon gjithçka e cila shkon përreth. Vëzhgimi i mprehtë por edhe sintezat që bën gjykimi i Panaritit, shkon në një ekuacion me vetë atë mënyrë sesi ngjyra zërthen veten në hapësirën e vet, që e percepton autori. Entoni s'është thjesht një

vite ka ndryshuar dhe sidomos përmirësuar jo vetëm idetë dhe perceptimin e materies, por edhe teknikën dhe sidomos disiplinimin para idesë. Të gjithë këta faktorë, që një pjesë e dashamirëve të tij, e lidhnin me fëmijërinë dhe me një kohë ku megjithë përkorjen ka pasur shumë dritë, e bëjnë pikturën e tij shumë vitale dhe që e kërkon bashkëbisedimin direkt me përfytyrimin që ngrihet të çdo shikues. Dhe, një gjë e cila nuk duhet lënë mënjanë: në artin e këtij piktori, shumë nga bashkëmoshatarët e vet por edhe më shumë akoma dhe breza të tjerë gjeten një pjesë të përfytyrimit të tyre për jetën dhe kohët në të cilët kemi jetuar.

Dhe, autori u mundua që atyre, që mëdhyshonin për ngjyrën t'u theksonite dhe një element, që ka pak karakter antik: dritën e parezistueshme të Mesdheut, atë për të cilën janë derdhur poezi pa fund dhe bota e ka futur në të gjitha gjinitë e artit që në kohët antike. Entoni bëri një vend modest në këtë koloni duke e lidhur me materien e vet, shoqëruar në çdo kohë me perceptimin që vjen para së gjithash nga nënvetëdija, atje ku kujtimet e fëmijërisë, bashkëjetojnë me sintezat e leximeve, kultura dhe mesazhet që jep përditmëria.

Ndaj, në telajo të ndryshme "ngjyrat janë konceptuar si një lloj muzike. Një telajo përfaqëson diçka personale, që lidhet me një situatë të caktuar. Zakonisht është ngjyra dhe drita, ngjyra është ajo që në këtë rast bën dritën" thotë piktori Panariti. "Nga të qenit në Amerikë unë kam mësuar shumë gjëra, por ajo që ka ngelur gjithmonë me mua nga Shqipëria atje ka qenë gjithmonë drita" u shpreh ai në ditët e ekspozitës.



P

POEZIA

Melankonia e një jete tjetër, larg vendit, është një nga motivet që kaplon autoren, e cila jeton prej vitesh jashtë vendit...

NGA INIS JORGO

MES HESHTJES..

Nuk do të të thërras dhe pse e di Se zërin m'a dëgjon Nuk do të të flas por do t'afrohem Mes gjetheve të shkelura Kuptoje se pranë më ke Mes heshtjes le të flasim, E di që malli të ka marrë Ndaj ti dërgoj mëngjeset Takoji ato e prejka vesën Se mua do t'më prekësh Ti ndjeja erën, dritën merrja E unë le të errem ! E di se malli do t'ket marrë Kështu me ndodh dhe mua.. Pranë do të vi por s'do të të zgjoj Tundimeve të tua.. Unë të premtoj, se s'do të të flas Veç do të të coj mëngjeset Ti do e dish, për ty jam nisur Mes heshtjes e mes vesës ..

MONOLOG NË ERRËSIRË

Përse kërkova falje kur gabim nuk ndjeja? Përse mendova se ka kohë, ndërsa pritja kohën vriste? Përse u frikësova, kur kurajon e kisha pranë? Përse arsyen e kërkova, mendjeve ku ajo mungonte? Përse desha të arratisem, kur muret më rrethonin? Përse desha të rritem aq shpejt dhe të jem fëmijë harrova? Përse rrenda pas të përsosurës, kur tek e zakonshmia ajo fshihej? Përse nuk të telefonova, kur ti sa shumë e prisje? Përse i shmangësua ndryshimit, kur përmes tij, vec rritesha? Përse melankoninë, kur jeta kishte aq ngjyra.. ? Përse qesha aq pak, kur shpirti donte të vallëzonte? Përse mendova "për një ditë", kur cdo ditë ishte ajo që prisja? Përse tentova vetminë, kur ajo mbërriti aq papritur? Përse luftova me të djeshmen, kur e nesërmja ishte aq pranë? Përse prisja "momentin", kur sekreteve ai qe struktur? Përse i shkrova këto rreshta e nuk mbusha një gotë verë?.....

Qepallat po më mbyllën e s'po më binden.....përse?

DIMËR KANADEZ....

E pashë dimrin përsëri sot Ja ndjeva therjen kur trupit m'u ngjit Bashkë me mëngjesin heshtje-ngrirej Mëngjesi i ftohtë, që nis një ditë ..

Një tjetër ditë e dimrit tim Mundohem mes tij, të gjej, të shijoj Dritareve përtuar rrjedh mendimi E nga fryma ime ai ndryshon formë

Ky dimër mendon se më ka pranë Mëngjesi i heshtur nësoj mendon Nje dre sy-bukur ka ndalur e më sheh Kopshtit të zbrazur me pas vrapon

Tashmë jam mësuar me këtë stinë M'u desh pak kohë, s'është her e parë Përherë mëngjeseve këtu do jem Mëngjeseve gri, me diell të rrallë..

Opinioni / Ditës

Politika e çimkave me çimka

Nga Lorenc Vangjeli

(vijon nga faqja 1)

... Dikur, komunizmi ishte një sistem që ngrihej mbi idenë e përgjimit të gjithçkaje dhe gjithkujt. Atëherë edhe vetëm dyshimi e bënte direkt fajtor qytetarin dhe mbi këtë bazë, ky instrument i padrejtësisë së djeshme politike është përdorur shumë shpesh ndaj të pafajshmëve. Noterizimi i fajësisë më pas ishte vetëm një akt formal i gjykatave formale, që vendosnin në emër të popullit, por natyrisht pa pyetur popullin. Po në të njëjtin regjim grotesk të thagmave dhe frikës, mbretërisë së absurdit dhe absurdit mbret, izolimit total dhe urisë fizike e shpirtërore të të gjitha llojeve, uria seksuale arrinte kulmin tek ca tipa të veçantë. Ata tipat që gjëmonin nga pas çifte të reja në pritje për t'i zhveshur errësirës ndonjë copë rënkimi mashkulli apo pak aromë lëkure femërore. Dhe për t'u bërë pjesë e asaj pak dashurie të ndaluar me dy sy të shqyer në terr sa më pranë dy palë syve që mbylleshin përgjithësisht nga turpi, padija dhe ëndja prej së ndaluarës.

Çfarë bënin të parët ishte kriminale.


Maniakëria dhe perversiteti i të dytëve ishte i pështrirë dhe i neveritshëm.

Por, edhe të parët e të dytët bënin në thelb të njëjtën gjë: mbanin syrin në vrimën e çelësit për të parë çfarë ndodhte pas portave të mbyllura.

Sot është ndryshe vetëm në formë, sepse thelbi është pothuaj identik. Debatit për përgjimit dhe përgjimit si vetë debati kryesor i ditës janë moda që mbizotëron. Në shumë raste përgjimit kanë qenë fillës drejt provave që kanë shkatërruar banda apo që kanë gozhuar banditë ordinerë. Shumë nga njerëzit e botës së nëndeshme janë zbuluar pikërisht nga ky mjet i pazëvendësueshëm hetimi. Por, futja e këtij elementi në jetën e përditshme të politikës e ka denaturuar vetë mjetin e përdorur.

Nga koha e largët kur Doktor Berisha, një dashnor i apasionuar mbas përgjimeve, ra vetë pre e një audiopërgjimi, ato kanë shërbyer edhe për të rrëzuar fasada politikanësh. Në të njëjtën kohë kanë qenë pjesë e një lufte të vazhdueshme politike, ku palët pa pre kanë akuzuar njëra-tjetrën për përdorim të tyre në kundërshtim me ligjin.

Sot gjithçka ka shkuar në ekstrem. Politika me çimka, siç e përbuzte dje me të drejtë ish-kryeministri kur u bë viktimë e saj apo Çimko-Politika tani që duket se po i shërben atij vetë, po e bën rregull përdorimin e tyre maksimumi për politikën e ditës dhe mini-



mumi për interesa, që janë më të vogla se një kokërr misri dhe më të padobishme se një kokërr rërë.

Nëpërmjet përgjimeve janë bërë shantazhe për përfitime politike dhe pazare të vogla për vlera monetare të mëdha. Shembujt janë ulëritës. Të paktën tri dosje penale, shumë të ndjeshme për publikun janë provat që provojnë këtë pohim. Dosja '339', përgjimet e së cilës janë tregtuar politikisht dhe financiarisht duke vvarë

ndoshta përfundimisht mundësinë për zbulimin e të vërtetës, tashmë në kulmin e groteskut. Përdorimi i saj për shantazh të të gjitha formave, për pazare politike dhe përfitime monetare kanë shkatërruar thelbin e saj. Sot është po aq i rëndësishëm sa identifikimi përfundimtar dhe ndëshkimi i fajtorëve, edhe hetimi profesional mbi mënyrën sesi është bërë vetë hetimi.

Dosja tjetër me numër '184', që

paralajmërohet vazhdimisht se do të dalë në skenë dhe së fundmi dosja 'Babale', kjo sagë e llumit tonë publik, dëshmojnë edhe njëherë aftësinë e pakufishme të segmenteve të shoqërisë shqiptare për të qenë jo pjesë e mëkatit që kërcënon, por vetë mëkati që duhet ndëshkuar. Fillimisht me përbuzje. E më pas, edhe me neveri dhe largim e distancim nga e keqja dhe vetë neveria që afrohet ëndrra për ta mbajtur syrin në vrimën e çelësit të kundërshtarit. Politika e çimkave me çimka dhe Çimko-Politika është trashëgimia e keqe e komunistëve, që tundojnë fort sot demokratë e socialistë për ta përdorur ndaj njëri-tjetrit dhe për të neveritur më pas, të gjithë spektatorët e këtij spektakli të pështrirë.

"Javanews"

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të shqetësohen rreth asaj çfarë nuk ka ndodhur ende. Një sjellje e tillë do t'ju nervozojë jo vetëm ju, por edhe personat rreth jush. Mënyra më e mirë është ta ndryshoni një sjellje të tillë dhe të kërkonti mënyrat për t'u relaksuar psikologjikisht.

DEMI

Rrezikoni të humbisni mbështetjen e një personi që e konsideroni mik të ngushtë. Tregoni kujdes në marrëdhëniet me ata që kenë për zemër. Rekomandohet të tregoni kujdes edhe në çështjet e punës apo financat tuaja.

BINJAKET

Demat do të përfshihen në rutinën e kësaj dite. Në përpjekje për të vënë rregull në shpirt, hidhni gjërat e panevojshme, por mos e teproni. Gjithashtu, gjëni kohë për t'u përkushtuar vetes, pasi është e nevojshme të relaksoheni.

GAFORJA

Fati do t'ju buzëqeshë gjatë kësaj dite. Ka gjasa që të fitoni një lotari të vogël. Megjithatë, parashikohet që më shumë fat do të kenë në çështjet jo materiale. Do të kaloni një mbrëmje të qetë nën praninë e familjes suaj.

LUANI

Mund të përballeni me disa probleme në jetën personale. Do të mendoni ti ktheheni lidhjes së mëparshme. Çiftet e martuara do të surprizohen nga një dhuratë që do t'i gëzojë pamasa. Ka gjasa të shkoni në një festë, në të cilën nuk kenë qenë asnjëherë më parë.

VIRGJERESHA

Virgjërësat do të kenë një ditë plot aktivitet. Ka gjasa të bëni një udhëtim të shkurtër. Është e rëndësishme t'i përkushtoheni vetes dhe mirëqenies suaj. Mos i shpërfillni këshillat e miqve apo disa rekomandime në internet.

PESHORJA

Disa Peshore janë të destinuara të bëhen magnet për seksin e kundërt. Ata që nuk janë ende në një marrëdhënie romantike kanë shumë mundësi për të gjetur partnerin/partneren e tyre. Shmangni shpenzimet e tepërta dhe artikujt luksozë.

AKREPI

Do të karakterizoheni nga luhajtje të mëdha humori. Ekziston mundësia që kjo të ndikojë në planet tuaja ose ti vërë në rrezik ato. Nëse jeni përgjegjës për një grup personash, përpuni ti qetësoni ata sa më shpejt të jetë e mundur.

SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do të kenë një ditë shumë të ngarkuar. Do të jeni të detyruar të kryeni shumë detyra. Disa persona do të kenë nevojë për ndihmën tuaj. Megjithatë, mos harroni planet personale. Ndoshta mund të takoni dikë që do t'ju ndryshojë jetën.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do t'ia kushtojnë këtë ditë plotësisht vetes. Megjithatë, nuk përfaqësohet mundësia që sot t'ju vizitojë dikush që e konsideroni të mirëditshëm. Komunikoni më shpesh me fëmijët, pasi kjo do t'ju ndikojë mjaft mirë në gjendjen tuaj emocionale.

UJORI

Mos e shpenzoni këtë ditë duke u përpjekur të gjëni fajtorin për një çështje të caktuar. Mos u tregoni jotolerantë ndaj miqve. Rekomandohet të bëni një udhëtim të shkurtër, të bisedoni me miqtë ose me familjarët për problemet që ju shqetësojnë.

PESHQIT

Mos hezitoni të ndërmerrni një vendim të rëndësishëm gjatë ditës së sotme. Besojini intuitës dhe ecuri përpara. Harroni komplekset, problemet e pazgjidhura dhe përkushtojuni argëtimit.

Analiza e Ditës

Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar

Dr.Uran Butka

Historian

(vijon nga faqja 1)

... të masakrës nga Kosova dhe trevat shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi.

Del pyetja: Përse kam hulumtuar dhe angazhuar kaq gjatë, për gati 25 vjet, për këtë ngjarje tragjike: Sepse është një masakër me përmasa ballkanike, sepse pati afër 4000 shqiptarë të pafajshëm të vrarë e mjaft të zhdukur, sepse kjo masakër është fshehur dhe vazhdon të fshehet nga politika, për të mos nxjerrë përgjegjësitë dhe fajtorët. Kjo është njëra anë, ajo e historianit, për të zbardhur dhe nxjerrë të vërtetën historike; ana tjetër botimi "Masakra e Tivarit" është edhe një homazh për të rënë, për të zhdukurit e pafajshëm, por edhe për familjet e tyre, që u lënduan dhe u persekutuan pa fund. Në këtë libër familjarët do të gjejnë emrat e të rënëve, janë botuar këtu listat e tyre.

Po le t'i kthehem historisë.


Platforma politike dhe ushtarake e projektit të shtetit komunist jugosllav ishte projekti famëkeq i Čubriloviçit i 7 marsit 1937 dhe i 3 nëntorit 1944. "Dy janë mënyrat për spastrimin etnik të shqiptarëve: t'i zhdukim, ose t'i shpërngulim". Masakra e Tivarit i përmbushi plotësisht këto synime antishqiptare.

Pikërisht në fillim të nëntorit 1944, komandave të Ushtrisë NÇJ iu dha, nga ana e organeve më të larta partiake dhe ushtarake të Serbisë, direktiva që të "vrisnin së paku 50% të banorëve shqiptarë".

Ky gjenocid shpërfaqej hapur në formën e vrasjeve masive të shqiptarëve të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare nga forcat e Ushtrisë NÇJ të Jugosllavisë, të OZN-ës dhe nga detachmentet çetniko-drazhiste, por edhe me ndihmesën e formacioneve ushtarake NÇJ të Shqipërisë.

Titoja, në cilësinë e komandantit të përgjithshëm të Ushtrisë NÇJ, i kërkonte E. Hoxhës kalimin e formacioneve të UNÇJ të Shqipërisë në Kosovë dhe Jugosllavi, për të luftuar kundër "pushtuesve dhe reaksionit". Kjo kërkese u formulua në fund të muajit maj, u përsërit në korrik e gusht të vitit 1944. U ribë edhe më 26 gusht 1944 nga Shtabi i UNÇJ për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit, firmosur nga komandanti i këtij shtabi, Fadil Hoxha dhe komisari Boshko Čačić.

Pala shqiptare u tregua e gatshme. Më 12 shtator 1944 komandanti i përgjithshëm i UNÇSH, E. Hoxha, i dha urdhër Korparmatës III të përgatiste dhe të nishte menjëherë dy brigada për në Kosovë. Kështu u dërguan në Kosovë Brig. III dhe V nën komandën e Shefqet Peçit.



Dërgimi i brigadave partizane të Shqipërisë në Kosovë u mbajt në konspirativitet edhe për britanikët, ndonëse ata ishin aleatë dhe ndihmonin Luftën Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe Jugosllavi. Enver Hoxha porosiste Dali Ndreun, komandantin e Korparmatës I: "Të mos i tregohet inglizëve objektivi i brigadave V dhe III, që do të shkojnë në Kosovë".

Titoja thirrri brigadat dhe divizionet e Ushtrisë NÇJ të Shqipërisë "për të luftuar kundër armikut dhe reaksionit", por i përdori kryesisht në luftën kundër "reaksionit shqiptar".

E. Hoxha e dinte mirë pse thirreshin brigadat nacionalçlirimtare të Shqipërisë në Kosovë, ndaj si një vasal i bindur dhe i ndërgjegjshëm për çka bënte, urdhëronte brigadat e Divizionit I: "Të asgjësohen pa mëshirë nacionalistë dhe reaksionarët shqiptarë brenda dhe jashtë kufijve pa treguar as më të voglën tolerancë".

Në muajin nëntor 1944 u angazhuan në këtë luftë edhe Divizioni V dhe Divizioni, që u vunë nën urdhrat e Armatës V të Ushtrisë NÇJ Jugosllave. Në urdhërverprimin e Armatës V të Jugosllavisë përfshiheshin edhe divizionet e Shqipërisë: "Të gjitha forcat reaksionare që do të takoni, të rrethohen dhe të shpartallohen me çdo kusht... Të carmatosen njerëzit e dyshimtë dhe ata që nuk duan të mobilizohen me dëshirë, të digjen

shtëpitë e tradhtarëve që rezistojnë dhe bëjnë fortesë... Të sekuestroni mallin e kriminelëve të arratisur. T'u theksohet katundeve që përshkoni se ai katund që bëhet strehë i gjaktorëve, do të dënohet...".

Divizionet V dhe VI të Shqipërisë ndodheshin në Kosovë përgjatë muajve mars dhe prill të vitit 1945, kur u bë masakra, me në krye Ramiz Alinë, komisar dhe Gjijn Markun e Rahman Perllakun komandantë. Këta rekrutuan mijëra shqiptarë të Kosovës dhe ua dorëzuan ushtrisë jugosllave, si mish për top, që i shpërnguli nga Kosova dhe i asgjësoi në Srem, Tivar etj.

Kemi në dorë radiogramet e shtabit të Divizionit V dhe VI dërguar Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë NÇJ të Shqipërisë gjatë muajve mars-prill 1945 e në vazhdim si edhe listat emërore të të arratisurve dhe vullnetarëve shqiptarë të Kosovës, që dorëzoheshin nga shtabet e diviz. V dhe VI tek ushtria jugosllave.

Ja edhe përgjigjja e Enver Hoxhës:

"Tarratisurit e dorëzuar në Divizionin tuaj, dërgojani Divizionit të 52 të Serbisë".

Për shoqërimin e tyre nëpër Shqipëri, nga Kukësi, në Pukë, Gomsiqe, Vau i Dejës, Drin, Bunë, Shkodër ishin caktuar disa batalione të Divizionit të 46-të dhe një batalion i Brigadës 27-të të Serbisë, si edhe një grup prej 50 ushtarakësh

nga Armata IV. Në një dokument Enver Hoxha justifikohet para tu-torëve të tij jugosllavë se nuk mundet t'i shoqëronte kolonat me kosovarë, sepse nuk kishte mjetet e nevojshme, por ai lejonte që ato të kalonin nëpër Shqipëri dhe urdhëronte Korparmatën në Shkodër që të bashkëpunonte me forcat ushtarake jugosllave (Radiogram dërguar Korparmatës III Shkodër).

Kalvari i masakrës nisi më 24 mars 1945, kur kolonat me kosovarë të rekrutuar dhunshëm u nisën nga Prizreni për në Kukës dhe kaluan nëpër territorin e Shqipërisë përgjatë muajve mars-prill. Të dhënat burimore ushtarake jugosllave tregojnë se u mobilizuan dhe u dërguan për në frontin e Adriatikut 13.323 rekrutë shqiptarë. Qeveria shqiptare, së pari lejoi që kolonat e ushtrisë jugosllave të hynin e të kalonin nëpër territorin e Shqipërisë dhe të asgjësoheshin shqiptarët e Kosovës të konsideruar "reaksionarë".

Në një dokument të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë lexojmë: "Me mijëra kosovarë të pafajshëm janë pushkatuar në masë, ilegalisht dhe pa gjyq nga organet e UDB-ë. Në këto masakra të pashembullta ndaj popullsisë së Kosovës ka marrë pjesë Koçi Xoxe, në fillim të vitit 1945, kur në cilësinë si ministër i Brendshëm i Shqipërisë, ai autorizoi oficerët e UDB-së që të pushkatonin ilegalisht dhe pa gjyq, në tokën shqiptare, më tepër se 1000 kosovarë të pafajshëm".

Natyrisht, ky është akti më antikombëtar dhe më i turpshëm i qeverisë komuniste shqiptare, kur lejua që të vriteshin shqiptarët në tokën shqiptare nga të huajt dhe u hesht plotësisht për këtë masakër, që përbën një gjenocid të pastër për motive politike dhe spastrimi etnik.

Qeveria shqiptare dhe E. Hoxha, këtë krim ia ngarkoi Koçi Xoxës, kur ai u dënua në vitin 1949. Mirëpo ministri i Brendshëm i Shqipërisë në vitin 1945 nuk ishte Koçi Xoxe (edhe ky kriminel) por Haxhi Lleshi, i cili lidhi marrëveshje me ministrin e Brendshëm të Jugosllavisë, Ranković dhe bashkëpunoi me të për asgjësimin e shqiptarëve të pafajshëm.

Nga raporti i shtabit të Kolonës IV të Armatës së Jugosllavisë, datë 8 prill 1945: "Eshaloni shkoi mirë deri në Kukës. Në afërsi të Kukësit ndodhi një incident, kur njëri nga grupi i kolonës gjuajti një bombë mbi rojën tonë. Me çrast u shkakua rrëmujë dhe në këtë rrëmujë arriti të arratiset një grup prej 10 vetash. Kështu, duke ikur, hasi në patrolën e ushtrisë shqiptare, e cila i ndaloi dhe iu bëri thirrje që të dorëzohen. Ndaj kësaj thirrjeje, ata nuk u përgjigjën, por vazhduan të iknin. Ushtarët shqiptarë hapën zjarr mbi ta dhe vranë në vend dy persona, dy të tjerë i plagosën, të cilët më vonë edhe ata vdiqën".

Siç shihet qartësisht nga ky do-

kument, asgjësimi i rekrutëve shqiptarë të Kosovës u krye në bashkëpunim të forcave ushtarake të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, në këtë rast brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (nga dokumentet jugosllave).

Rekruti Azem Hajdini - Xani, i cili përjetoj tmerrin e masakrës së Tivarit, por rastësisht shpëtoi nga vdekja dhe dëshmoi për këtë tragjedi kombëtare: "Kur hymë në territorin e Shqipërisë, u gëzuan pa masë, - parashtron Azem Hajdini - duke menduar se tash e tutje do të jemi nën përcjelljen e ushtarëve të shtetit tonë, Shqipërisë dhe se nuk do të përjetonim mizoritë, siç i kishim përjetuar vazhdimisht në Kosovë nga serbët, malazezët dhe maqedonasit. Shumë shpejt, pra, u bindëm se as këtu nuk kishte vend për gëzim, sepse skenari i parapërgatitur vazhdon të realizohet me përpikmëri dhe ngase gjatë rrugës nëpër territorin e Shqipërisë, përcjellësit i shtonin torturat e vrasjet ndaj nesh. Ata nuk na konsideronin më si bashkëluftëtarë të tyre, madje as si robër të luftës... Neve nuk na konsideronin as si kope bagëties".

Sipas të dhënave të arkivave jugosllave në Kukës, Pukë, Fushë-Arrëz, Gomsiqe ranë në kanionin e thellë dhe gjetën vdekjen 36 rekrutë dhe 14 u plagosën; në Vau e Dejës, në lumin Drin dhe në lumin Buna dhe në Shkodër gjetën vdekjen qindra rekrutë shqiptarë dhe u lënduan një numër i madh të plagosurish.

Në mesditën e datës 31 mars 1945, në qytetin e vogël të Tivarit, ishte ngritur kurthi, sipas një plani të parapërgatitur për asgjësimin e gjithë rekrutëve shqiptarë. Masakrën ishte ngarkuar ta kryente Brigada X malazeze, pikërisht në Tivar, qytet shqiptar, që përfshihet në Malin e Zi.


Kasaphana nisi në hyrje të Tivarit të RI, mandej arriti pikun e saj në oborrin dhe në mëdjetet e ndërtesës së Monopolit të Duhanit, më 31 mars të vitit 1945. Sipas përlogaritjeve rezultan se vetëm në Tivar u vranë 1560 shqiptarë nga kolona e dytë. Edhe nga kolonat e tjera me rekrutë shqiptarë të mobilizuar kryesisht në viset shqiptare të Qostivarit, Tetovës, Kumanovës, Kërçovës dhe Shkupit gjatë marshimit nëpër Shqipëri të njëjtin fat patën.

Nëse përligjejmë të konkludojmë për numrin e saktë të të vrarëve në këtë tragjedi të përmasave ballkanike, numrit i rezultan shuma prej 3447 shqiptarësh të vrarë, të mbytur, të helmuar, përveç të zhdukurve që s'u gjenden kurrë në tragjedinë e qajtur të Tivarit.

Botimi "Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar" është një trajtim shkencor, një përpjekje për të treguar të vërtetën e fshehur, për të reflektuar, por edhe një homazh për të vrarët e të zhdukurit e pafajshëm, që jo vetëm historia, por edhe politika i ka harruar.

Deri kur kështu?

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Që harkëtar i famshëm i akejev.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vetëvrësar.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshtë anije me dy skafe.
- Fundi i Turandot.
- Iniciale e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajinë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendrik.
- Një është meskini, shpirtnugsh-ti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Eshtë shpend lagune.
- Eshtë operator që bën zoom.
- Eshtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike.
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë statet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film.
- Eshtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist.
- Fadili komik.
- Përhëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takim.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishtë shkollë e Aristotelit.
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle.
- E famshme ajo e Keopsit.
- Mbyllin një sirtar.
- Eshtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.

VERTIKAL


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Erzohen me strike.
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet.
- Eshtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti.
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa.
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbolli.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshtë lon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M A R I E K O H A A K
F T L L I D O M A N T E R
R A E T M I M R S E
A A P E R T P A T I M
N H P A K E T I M E T T
Z E M E R A K E T S T I
F I D A N E T V E T E M
S E N A T I I B E R I K E
S E N E K A L L A P A T
T R E E L S A T T
L I V E I A K A A D
N A A R N J E A P E L

D A L A I V A K A N T E
E D E N P N A D I A M
R R E M I R E T T R I O
T E S T R T A T E O L
S M N O T A R E T N L
K A A M E R T N A N E H
E S H P A M A D S H
K O L O N A O T L E C E
T U N E L E T P E R O S
O R A I T K E S T I A
K A N S A R A H E P
E T J A C I T A T E T I

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	3			8		5		7
6	4					3		1
			2	4		8	9	
		1	9					2
7	9		8		4		3	5
5					7	6		
	7	3		6	2			
9		2					6	4
8		5		7				1

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	8	2	6	5	3	7	1	4
6	1	3	7	8	4	9	2	5
5	7	4	9	1	2	3	6	8
7	6	5	8	2	9	1	4	3
8	3	9	1	4	5	2	7	6
4	2	1	3	6	7	5	8	9
1	5	6	2	9	8	4	3	7
2	9	7	4	3	6	8	5	1
3	4	8	5	7	1	6	9	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- I vetmi mashkull që do të më bëjë të vrapoj pas tij, do të jetë ai që do të më thërrasë...Më kap Maaaaaa. (X Mom)

- Nëse ndihmoni një shok në nevojë, ai me siguri do t'ju kujtojë herën tjetër kur të gjendet në nevojë.

- Shpesh ne kundërshtojmë opinionin, ndërsa nuk na pëlqen vetëm toni me të cilën është shprehur.

- Personat që na japin besimin e tyre të plotë kujtojnë se kanë fituar kështu të drejtën që edhe ne t'ju japim besimin tonë.

Thënie të mençura

• Shumë premtime ulin besimin.

• Gjysma e gënjeshtreve që thonë për mua, nuk janë të vërteta.

• Personave që nuk i duam ua llogarisim mirësjelljet që shfaqin ndaj nesh si fyerje.

KRIPOTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16	7	5	15	8		3	8	
1	Z	8	13	8	6		6	8	4	5	8	12
2	I	7	10	8	9	2		15	2	11	3	2
9	L	14	8	12	17	12	5	7	9	9	2	
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7
7	5	7	12	7	15	6		11	6	8	15	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7
5	4	11	6	19		9	8		4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7	
5	7	8	4		8	9	5	8	15	7	5	

I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T	
B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
R	R	I	T	I	U	I	T	A			
A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
T	K	D		T	E	A	N	T	A		
U	N	I	O	N	M	R	A	T	K		
A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
L	K	S		T	U	R	I	S	T	E	T

• - Askush nuk i është mirënjohës njeriut me shpirt të madh
• për mirësjelljen e tij, kur ky i përshatet një shoqërie ku
• nuk është e sjellsme të tregosh se ke shpirt.
•
• - Kushdo që i jep shembull shokëve të tij në vend të
• këshillave, ai konsiderohet i mençur.

